



6

# FJALËT' E-URTA TË SOLLOMONIT

---

KTHYERË PREJ EBRAISHTESË  
SHQIP  
NDË TË-FOLË TOSKËRISHT



MANASTIR

*Shtyp. ndë shtyp. „Tregëtare, Nër-kombëtare“*

1912

MANASTIR LIBRARY  
1912

LIBRARY OF THE  
Massachusetts  
Bible Society

Catalog No. A.320.2(3)/PR1912

Family INDO-EUROPEAN

Sub-Family THRACO-ILLYRIAN

Branch ILLYRIC

Group —

Language ALBANIAN

Dialect UNION

Locality Albania

Contents PROVERBS

Version UNION

Translator —

Published by Shtyp. Treg. Nêrkom.

Place MANASTIR Zëtare

Date 1912

Accession No. 496

Accession Date SEPT 17, 1930

Price 82/21

# FJALËT' E-URTA

## Krye 1.

- 1 Fjalët' e-urta të Sollomonit, të birit të Davidit, mbretit të Israilit,
- 2 Që të njohë *njeriu* urtësi e dituri, që të kupëtonjë fjalë urtësie,
- 3 Që të marrë mësim urtësie, e së-drejte, e gjyqi, e drejtërie,
- 4 Që t' u apë kupëtim të-mituret, e mësim e të-çquarë të-riut.
- 5 I-urti dyke dëgjuarë dotë bënetë m' i-urtë, edhe i-kupëtuarshimi dotë arrinjë ndë mendime të-fortë;
- 6 Që të kupëtonjë fjalë të-urtë, e fjalë t' e-rrëtë, ligjeratat' e të-urtëvet, e fjalët' e-thella t' atyreve.
- 7 § Kryet' e diturisë është frik' e Zotit; të-marrëtë çpërunderonjë në urtësin' e mësimnë.
- 8 § Dëgjo, o biri im, mësimn' e t' yt et, edhe mos hith tej nomn' e s' at' ëme.
- 9 Sepse këto *dotë jenë* kurorë hiri nde kryet t' ënt, edhe qafore rreth qafësë s' ate.
- 10 § Biri im, ndë daçinë fajtorëtë të të gënjenjë në, të mos duash;
- 11 Ndë thënçinë, Eja bashkë me ne, letë bëjmë pritë për gjak, letë mendojmë të-keqe pa ndonjë ngajë kundër të-pafajmit;

- 12 Let' i përpijm' ata të-gjallë, posi hadhi,  
edhe të-tërë posi ata që sbresënë ndë gropët;
- 13 Dotë gjejmë çdo gjë të-paçëmuarë, dotë  
mbushmë shtëpitë t'ona me plaçka;
- 14 Vërë shortënë t'ënde ndë mest t'ënë; një  
kuletë letë jetë ndër ne të-gjithë;
- 15 Biri im, mos ecë udhësë bashkë me ata;  
hiq këmbënë t'ënde nga udhët' e atyreve;
- 16 Sepse këmbët' e atyreve sulenë mbë të-  
keqet, edhe nxitonjënë për të derdhurë gjak.
- 17 Me të-vërtetë kot ndehetë rrjetë përpara  
syvet çdo shpesi.
- 18 Sepse këta bënjënë pritë kundrë gjakut  
të vetëhes' së tyre, mendonjënë të-keqe për  
jetën' e tyre.
- 19 Të-tilla *jan'* udhët' e çdo lakmonjësi; *lak-*  
*mimi* ngre jetën' e atyrevë që janë pushtu-  
arë prej atij.
- 20 Ş Urtësia këlthet jashtë; nxjer zërin' e saj  
ndëpër udhët të-gjera;
- 21 Thërret ndëpër vëndet të-parë, ndë të-ci-  
lët mblidhetë gjindje, ndëpër të-hyrat të dy-  
eret; flet fjalët' e saj ndëpër qytett, e *thotë*:
- 22 Gjer kur, o të-marrë, dotë doni marrë-  
sinë, edhe përqeshësitë dotë kënaqenë me  
të-përqeshurat' e tyre, edhe ata që s' kanë  
mënt dotë mërzitnjënë diturinë?
- 23 Kthehuni ndë të-qërtuarët t'im; na unë tek  
dotë derth frymënë t'ime mbi ju, dot' u bënj  
të kupëtoni fjalët' e mia.

- 24    § Sepse unë thërrisnjam, po ju nukë dëgjo-  
nitë; ndenjam dorënë t'ime, po asndonjë nukë  
mbante vesh;
- 25    Po bënitë për asgjë gjithë këshillat'e mia,  
edhe nukë pritninë qërtimet'e mi;
- 26    *Përandaj* edhe unë dotë qesh me prishje-  
në t'uaj; dotë gëzonem, kur t'u vinjë frika.
- 27    Kur t'u vinjë frika posi shkretim, edhe  
prishja juaj të suletë posi erë shakulli: kur  
të vinjënë mbi ju shtrëngimi e ngushtimi;
- 28    Atëhere dotë më thërresënë, po nukë dotë  
përgjigjem; dotë më kërkonjënë me të-çpejtë,  
po nukë dotë më gjenjënë.
- 29    Sepse mërzitnë diturinë, edhe nukë zgjoth-  
në frikën'e Zotit;
- 30    Nukë deshnë këshillat'e mia; hothnë tej  
gjithë qërtimet'e mi;
- 31    *Përandaj* dotë hanë nga pemët'e udhës'  
së tyre, edhe dotë nginjenë nga mendimet'e  
tyre të-këqinj.
- 32    Sepse të-marrëtë dot'i vrasë marrësia e  
*atyre*, edhe ata që s'kanë mënt pakujdesja  
e *atyre*.
- 33    Po ay që më dëgjon mua, dotë rrijë ndë  
siguri, edhe dotë jetë ndë prëhje, pa pasurë  
frikë prej së-keqeje.

## Krye 2.

- 1    Biri im, ndë priç fjalët'e mia, edhe ndë  
vlofsh porosit'e mia ndë vetëhet t'ënde,

- 2 Që t'i mbash vesh diturisë, edhe të unjç  
zëmërenë t'ënde ndë urtësit;
- 3 Ndë thërriq diturinë, edhe të ngresh zënë  
t'ënt ndë urtësit;
- 4 Ndë kërkofsh atë posi ergjënt, edhe ndë  
kërkofsh atë posi thesarë të-fshehurë;
- 5 Atëhere dotë kupëtonjç frikën' e Zotit, edhe  
dotë gjenjç të-njohurit' e Perëndisë.
- 6 Sepse Zoti ep urtësi; prej gojës' s'ati *del*  
mëndje e dituri.
- 7 Vlon shpëtim për të-drejtëtë; *është* mbu-  
ronjë mbë ata që ecënjënë drejtë,
- 8 Dyke mburuar' udhët' e drejtërisë, edhe  
dyke ruajtur' udhët' e të-drejtëvet të tij.
- 9 Atëhere dotë kupëtonjç drejtëri, e gjyq,  
e të-drejtë, e çdo udhë të-mirë.
- 10 § Ndë hyftë urtësia ndë zëmëret t'ënde,  
ëdhe të-kupëtuarëtë të kënaqnjë shpirtinë t'ënt,
- 11 Këshill' e-drejtë dotë të ruanjë, urtësia  
dotë të mbanjë;
- 12 Që të të shpëtonjë nga udh' e-ligë, prej  
njeriu që flet gaba;
- 13 Të-cilëtë lënë udhët' e drejtërisë, që të  
ecënjënë nd' udhët t' errësirësë;
- 14 Të-cilëvet u pëlqen të bënënjënë keq, edhe  
gëzonenë ndë të-përdredhurat të së-keqesë;
- 15 Udhët' e të-cilëvet janë të-shtrëmbëra, edhe  
të-ecurat' e atyre të-përthyerat;
- 16 Që të të shpëtonjë nga gruaj' e-huaj, nga  
e-huaja që përkëdhel me fjalët' e saj;

- 17 E-cila hoqi dorë nga i-dashuri i vajzëris'  
së saj, edhe harroj dhjatën' e Perëndis' së saj;
- 18 Sepse shtëpia e asaj sbret ndë vdekjet,  
edhe çapet' e asaj ndër të-vdekurit;
- 19 Gjithë sa hynjënë tek ajo nukë kthenenë,  
as nukë marrënë më udhët' e jetësë;
- 20 Qe të ecënç nd' udhët te të-mirëvet, edhe  
të ruajsh rrugat' e të-drejtëvet.
- 21 Sepse të-drejtëtë dotë rrinë ndë dhet, e-  
dhe të-sosuritë dotë mbetenë nd' atë.
- 22 Po të-pabesëtë dotë këputenë nga dheu,  
edhe të-paudhëtë dotë çkullenë prej atij.

### Krye 3.

- 1 Biri im, mos harronç nomet' e mi, edhe  
zëmëra jote letë ruanjë porosit' e mia;
- 2 Sepse dotë shtonjënë te ti dit të-gjata, e  
vite jete, e paqtim.
- 3 Ş Përdëlimi edhe e-vërteta letë mos të  
lënë; lidh-i ato rreth qafësë s' ate; gërvisht-i  
ato mbi dërrasat të zëmërësë s'ate;
- 4 Kështu dotë gjenç hir e sy të-mirë për-  
para Perëndisë e njerëzet.
- 5 Ş Besohu mbë Zotinë me gjithë zëmërënë  
t'ënde, edhe mos umba ndë mëndjet t'ënde;
- 6 Mbë gjith' udhët' e tua njih atë, edhe ay  
dotë drejtonjë çapet' e tu.
- 7 Ş Mos kujto vetëhenë t'ënde për të-diturë;  
ki frikë Zotit, edhe priru nga e-keqeja.

- 8 *Kejo* dotë jetë shërim ndë dejet të tu, edhe palcë ndër eshtërat të tua.
- 9    § Ndero Zotinë me pasjenë t'ënde, edhe me të-lashtat' e gjithë t'ardhuravet të tua;
- 10 *Edhe* dotë mbushenë grunarët' e tu plot, edhe koritat' e tua dotë mbushenë perbuzë me verë të-re.
- 11    §. Biri im, mos hith tej mësimn' e Zotit, edhe të mos të vinjë rëndë, kur qërtonjesh prej atij;
- 12    Sepse Zoti qërton atë që do, sikundrë edhe ati të birrë që pëlqen.
- 13    § Lum ay njeri që gjeti dituri, edhe ay njeri që fitoj urtësi;
- 14    Sepse tregëtia e asaj *është* më e-mirë se tregëtia e ergjëndit, edhe fitimi i asaj *më i-mirë* se ari i-kulluarë.
- 15    Është më e-nderçime se gurët' e-paçëmuarë; edhe gjithë sa të dëshëronjç nukë janë aqë të-vëjyera sa ajo.
- 16    Dit të-gjata *janë* ndë të-djathtët t'asaj; ndë të-mëngjërët t'asaj janë pasje e lavdi.
- 17    Udhët' e asaj janë udhë të-gasçime, edhe gjithë rrugat' e asaj janë paqtim.
- 18    Është dru jete ndër ata që e pushtojnë; edhe lum ata që mbanjën' atë.
- 19    § Me anë të diturisë Zoti themelosi dhënë; forcoj qiejtë me urtësi.
- 20    Me anë të mëndjes' s'ati uhapnë pafundjetë, edhe retë pikonjënë vesë.



- 21 § Biri im, letë mos mërgonenë këto nga  
syt' e tu; ruaj këshillë të-drejtë e urtësi;
- 22 Edhe dotë kesh jetë ndër shpirtt t'ënt,  
edhe hir ndë qafët t'ënde.
- 23 Atëhere dotë ecënç udhës' s'ate pa frikë,  
edhe këmba jote nukë dotë pengonetë.
- 24 Kur të bjesh të flesh, nukë dotë tristoneh;  
po dotë bjesh, edhe gjumi yt dotë jet' i-ëmbëlë.
- 25 Nuke dotë trëmbesh nga frik' e-papande-  
hurë, as nga humbja e të-pabesëvet, kur të  
vinjë përsipërë;
- 26 Sepse Zoti dotë jetë shpresa jote, edhe  
dotë ruanjë këmbënë t'ënde që të mos zihetë.
- 27 § Mos u'a moho të-mirënë atyreve që du-  
hetë, kur është ndë dorët t'ënde t'a bësh atë.
- 28 Mos i thuaj të-afërmit t'ënt, Shko edhe  
kthehu, edhe nesërë dotë t'ap; kur e ke me  
vetëhe.
- 29 § Mos mendo të-keqe kundër t'afërmit t'ënt,  
kur ay të ka zënë besë e rri bashkë me ty.
- 30 § Mos uzërë me njeri pa ndonjë farë ngaje,  
ndë qoftë se s'të ka bërë *ndonjë* të-keqe.
- 31 § Mos i ki zili njeriut të-rrëmbyershim,  
edhe mos sgjith ndonjë prej udhëvet t'atij.
- 32 Sepse Zotit i vjen të-ndohëtë nga *njeriu*  
i-shtrëmbërë, po fshehësir' e ati është me  
të-drejtëtë.
- 33 § Mallëkim' i Zotit është ndë shtëpit të të-  
pabesit; po ay bekon vëndin' e të-drejtëvet.

- 34 Me të-vërtetë ay qesh përqeshësitë; po të-përunjurëvet u ep hir.
- 35 Të-urtëtë dotë trashëgonjënë lavdi; po të-lartët' e të-marrëvet dotë jetë turpëri.

## Krye 4.

- 1 Dëgjoni, o djem, mësim ati, edhe vini re të mësoni urtësi;
- 2 Sepse u ap juve mësim të-mirë; mos hiqni dorë nga nomi im.
- 3 § Sepse *edhe* unë qeshë i bir' i t'im et, idashur' e i-vetëmë përpara s'im mëje.
- 4 Edhe më mësonte e më thoshte, Letë mbajnë zëmëra jote fjalët' e mia; ruaj porosit' e mia, edhe dotë rronjç.
- 5 Fito dituri, fito urtësi; mos i harronjç; as mos priresh nga fjalët' e gojësë s'ime.
- 6 Mos hiq dorë nga ajo, edhe të ka për të ruajturë; doj-e atë, edhe të ka për të mbajturë.
- 7 Urtësia *është* më e-para *gjë*; fito urtësi; edhe më tepërë nga çdo fitim, fito urtësi.
- 8 Lartësoj-e, edhe dotë të lartonjë; dotë të lëvdonjë, kur t'a pushtonjç atë.
- 9 Dotë vërë mbi kryet t'ënt kurorë hires; dotë të apë koronë lavdie.
- 10 § Dëgjo, biri im, edhe prit fjalët' e mia; edhe dotë shumonenë vitet' e jetësë s'ate.
- 11 Të mësonj udhën' e urtësisë; të heq udhënë ndër rruga drejtërie.
- 12 Kur të ecënjç, çapet' e tu nukë dotë jenë

të-shtrënguarë; edhe kur të sulesh, nukë do-të pengonesh.

13 Rrok mësimnë, mos e lërë; ruaj-e atë, sepse është jeta jote.

14 § Mos hyrë ndë rrugët të të-pabesëvet, edhe mos shko nd' udhët të të-këqinjvet.

15 Largohu prej asaj, mos shko nga ajo, priru nga ajo, edhe ikë.

16 Sepse ata nukë flenë, ndë mos bëfshinë të-keqe; edhe u ngrihetë gjumi, ndë mos rë-zofshinë ndonjë.

17 Sepse hanë bukë pabesërie, edhe pinë verë shtrëngate.

18 Po udhë e të-drejtëvet është posi drita e-çkëlqyerë, që vjen dyke ndriturë shumë e më shumë, gjersa të bënetë dritë fare.

19 Udh' e të-pabesëvet është posi errësira; nukë dinë se ku pengonenë.

20 § Biri im, mbaj-u vesh ligjëratavet të mia; kthe veshinë t'ënt mbë fjalët' e mia.

21 Letë mos largonenë nga syt' e tu; ruaj-i ato ndë zëmëret t'ënde;

22 Sepse është jetë për ata që gjenjën' ato, edhe shërim për gjithë trupin' e atyreve.

23 Me çdo farë të-ruajturi ruaj zëmërenë t'ënde; sepse nga ajo janë burimet' e jetësë.

24 Hith lark teje gojën' e-shtrëmbërë, edhe largo prej teje buzët' e-shtrëmbëra.

25 Syt' e tu letë shikonjënë drejtë, edhe qe-pallat' e tua letë shikonjënë drejtë përpara teje.

- 26 Pesho të-ecurit' e këmbëvet të tua, edhe gjithë udhët' e këmbëvet të tua dotë venë drejtë.
- 27 Mos uprir mbë të-djathtë a mbë të mëngjërë; largo këmbënë t'ënde nga e-liga.

## Krye 5.

- 1 Biri im, mbaj-i vesh diturisë s'ime, kthej-i veshnë urtësisë s'ime;
- 2 Që të ruanç urtësi, edhe buzët' e tua të ruanjënë kupëtim.
- 3 Sepse buzët' e *gruas'* së-huaj pikonjënë *posi* hoj mjalte, edhe qiellëza e asaj *është* më e-butë se vaji;
- 4 Po fundi i asaj është më i-hidhurë se apsinthi, i-prehëtë *posi* thikë me dy presje.
- 5 Këmbët' e asaj sbresënë ndë vdekjet, çapet' e asaj shpienë ndë pisët.
- 6 Që të mos gjenç udhën' e jetësë, të ecurat' e asaj janë të-paqëndruara edhe jo të-çquara.
- 7 § Dëgjo-më-ni tashi pra, o djem, edhe mos dilni nga fjalët' e gojësë s'ime.
- 8 Largo udhënë t'ënde nga ajo, edhe mos uafëro ndë derët të shtëpis' s'asaj,
- 9 Që të mos apç nderinë t'ënt të-tjerëve, edhe vjett' e tu të-papërdëlllyershimvet;
- 10 Që të mos nginjenë të-huaj me pasjenë t'ënde, edhe mundimet' e tu të *hynjënë* ndë shtëpi të të-huaji,

- 11 Edhe ti të psherëtinjç më ndë funtt, kur  
të tretetë mishi yt, edhe trupi yt,
- 12 Edhe të thuash, Qysh mërzita mësimnë,  
edhe *qysh* zëmëra ime hodhi tej qërtimetë,
- 13 Edhe nuk' u dëgjova zënë atyreve që më  
mësoninë, as u'a ktheva veshnë atyreve që  
më këshilloninë!
- 14 Për pakëzë desh rashë ndë çdo të-keqe,  
ndë mest të mbshtjelljes' e të mbledhjesë.
- 15 § Pi ujë prej sternësë s'ate, edhe prej *ujt*  
që buron nga pusi yt.
- 16 *Përse* të derdhenë jashtë kronjet' e tu,  
edhe rrëket' e ujëravet ndëpër rrugat?
- 17 Letë jenë vetëmë për ty, e jo për të-hu-  
ajtë bashkë me ty.
- 18 Kroj yt letë jetë i-bekuarë, edhe gëzohu  
bashkë me gruan' e të-rit t'ënt.
- 19 *Letë jetë te ti* posi drere e-dashurë, edhe  
*posi* zorkadhe gazëtore; gjirët' e asaj letë të  
ujitnjënë mbë çdo kohë; gëzohu kurdo ndë  
dashurit t'asaj.
- 20 Edhe përse, o biri im, të ka ënda të-hua-  
jënë, edhe do të pushtonjç gjin' e së-huajësë?
- 21 Sepse udhët' e njeriut *janë* përpara syvet  
të Zotit, edhe ay peshon gjithë çapet' e atij.
- 22 § Të-ligunë vetë paudhërit' e tij dot'a zënë,  
edhe dotë zihetë ndë litarët të fajit të tij.
- 23 Ky dotë vdesë se s' ka mësim, edhe nga  
shumica e marrësis' s' atij dotë sillet' andej  
e këtej.

## Krye 6.

- 1 Biri im, ndë ubëre dorë-zënës për mikunë t' ënt, ndë dhe dorë për të-huaj,
- 2 Uzure ndë lakt me fjalët' e gojësë s' ate, uzure me fjalët' e gojësë s' ate.
- 3 Bëj këtë pra, o biri im, edhe shpëto, sepse re ndë duart të mikut t' ënt; shko, mos uloth, edhe shtrëngo mikunë t' ënt.
- 4 Mos u apsh gjumë syvet të ty, as të-dremiturë qepallavet të tua;
- 5 Shpëto si kapruall prej dorës' së-gjahtorit, edhe si zok prej dorës' s' atij që zë zoq.
- 6 § Shko te milingoneja, o purtesës, vështro udhët' e asaj, edhe bënu i-urtë;
- 7 E-cila pa të-parë, pa kujdestar, pa qiver-nitar,
- 8 Bën gati ushqimin' e saj ndë verë, mbleth të-ngrënat' e saj ndë të-korrët.
- 9 Qjer kur dotë flesh, o purtesës? kur dotë ngrihesh nga gjumi?
- 10 Pak gjumë, pak të-dremiturë, pak të-pshtjellurë duartë për gjumë;
- 11 Pastaj vjen vobëzia jote posi udhëtar i-çpejtë, edhe skamja jote posi burr' i-armatosurë.
- 12 § Njeriu i-pavëjyerë, njeriu i-lik, ecën me gojë të-shtrëmbërë;
- 13 Bën shënjë me syt' e tij, flet me këmbët' e tij, mëson me gishtërit' e tij;

- 14    § Me zëmërë të-shtrëmbërë mendon të-kë-  
qia mbë çdo kohë; mbjell zënje;
- 15    Përandaj papandehuraj i ka për të ar-  
dhuurë humbja; papandehuraj dotë dërmo-  
netë pa *shpresë* shërimi.
- 16    § Zoti mërzit këto të gjashta, po më fort kë-  
to të shtata i ka të-ndohëta shpirti i atij;
- 17    Sy madhështuar, gjuhë gënjeshtare, edhe  
duar që derthnjënë gjak të-pafajm,
- 18    Zëmërë që mendon mendime të-liq, këm-  
bë që ecënjënë me vrap për të bërë të-keqe,
- 19    Dëshmimtar të-rrem që flet gënjeshtërë, edhe  
atë që mbjell ngrindje ndër mest të vëllezërvet.
- 20    §. Biri im, ruaj porosin'e t'yt et, edhe mos  
hith tej nomin' e s'at' ëme.
- 21    Mbaj-i lidhurë përherë ndë zëmërët t'ënde,  
var-i rreth qafësë s' ate.
- 22    Kur të ecënjç, dotë të heqë udhënë; kur  
të flesh, dotë të ruanjë; edhe kur të sgjonesh,  
dotë flasë bashkë me ty.
- 23    Sepse porosia *është* kandile, edhe nomi  
është dritë, edhe qërtimet' e diturisë *janë* u-  
dhë jete;
- 24    Që të të ruanjë në nga gruaj'e-keqe, nga  
lajk'e gjuhës' së gruas' së-huaj.
- 25    Të mos dëshëronjë bukurin'e asaj ndë zë-  
mërët t'ënde, edhe letë mos të zërë si gjah  
me qepallat'e saj.
- 26    Sepse për punë të një gruaje kurvë arrin  
njeriu *ndë nevojë* gjer mbë një copë buke,

edhe gruaja me burrë që është kurvë gjuan  
të *humpnjë* shpirt të-paçëmuarë.

27    § A munt të vërë zjarr ndonjë ndë gjit të  
tij, edhe të mos i digjenë rrobatë?

28    A munt të ecënjë ndonjë mbi thëngjij të-  
ndezurë, edhe të mos i digjenë këmbëtë?

29    Kështu *është edhe* ay që hyn te gruaq' e  
të-afërmit të tij; kush të qaset' afër' asaj, nukë  
dotë dalë i-pafajm.

30    § Nuk' e mërzitnjënë vjedhësinë, ndë vjeth  
për të nginjurë shpirtin' e tij, kur ka uri;

31    Po ndë uzëntë, ka për të dhënë prapë  
për një shtatë; ka për të dhënë tërë gjën' e  
shtëpis' së tij.

32    Kush kurvëron me ndonjë grua, s'ka mënt;  
ay që bën këtë, vdjer spirtin' e tij.

33    Plagë e çnderim dotë ketë; edhe turpëria  
e atij nukë dotë shuhetë.

34    Sepse zilia është marrësi' e burrit, edhe  
s'i ka për të ardurë keq ndë ditët të të-ma-  
rrit çpagim.

35    Nukë dotë shikonjë as mbë ndonjë çpër-  
blim; as nukë dotë sbutetë, edhe ndë ja shu-  
mofsh dhuratatë.

### Krye 7.

1    Biri im ruaj fjalët' e mia, edhe vlo poro-  
sit' e mia ndë vetëhet t'ënde.

2    Ruaj porosit' e mia, edhe dotë rronjë; e-  
dhe nominë t'im, posi dritën' e syvet të tu.



- 3 Lidh-i ato mbi gishtërit të tu; gërvisht-i  
ato mbi dërrasët të zëmërësë s'ate.
- 4 Thuaj diturisë, Ti je motëra ime; edhe  
quaj urtësinë far'e fis;
- 5 Që të të ruanjënë nga gruaj'e-huaj, edhe  
nga e-huaja që përkëdhel me fjalët'e saj.
- 6 §. Sepse nga parathirja e shtëpisë s'ime  
vështova ndëpër trirët t'ime;
- 7 Edhe pashë ndër mest të të-marrëvet, e  
çquajta ndër mest të të-rinjvet një djalosh  
pa mënt;
- 8 I-cili shkonte rrugësë përanë çipit t'atillë  
*gruaje*, edhe kish marrë udhënë që vinte ndë  
shtëpit t'asaj,
- 9 Vonë mbë të-ngrysurit të ditësë, ndë t'  
errët të natësë, e nd'errësirët;
- 10 Edhe na tek e poqi atë një grua që e  
*kish* të-pamëtë si kurvë, edhe zëmërenë ga-  
bimtare;
- 11 Lomatare edhe e-paturpshime; këmbët'e  
asaj nukë qëndronjënë ndë shtëpit t'asaj;
- 12 Tashi gjëndetë jashtë, tashi ndëpër rru-  
gat, e rri e pret mbë çdo çip.
- 13 E zë atë edhe e puth, edhe me faqe të-  
paturpshime i thot'ati,
- 14 „Kam kurbanë paqtimi, sot pagova kush-  
timet'e mi;
- 15 „Përandaj dolla për të pjekurë ty, sepse  
më mori malli të shoh faqenë t'ënde, edhe  
të gjeta.

- 16 „Kam shtruarë shtratinë t'im me pëlhurë të-linjta e të-leshta qëndisurë me fije Egjyptërie.
- 17 „Kam pshtymurë shtratinë t'im me smir-në, me allojë e me qinamomë.
- 18 „Eja, letë dehemi me dashuri gjer mbë të-sbardashëllyerët; letë kënaqemi me dashuri;
- 19 „Sepse nuk' është burri ndë shtëpit, ka marrë udhë të-largë;
- 20 „Mori një kuletë me ergjënt ndë dorët të tij; dotë kthenetë ndë shtëpit të tij mbë të-mbushurit të hënësë.“
- 21 Me shumë mjeshtëri të saj e gënjeu atë; me lajkat' e buzëvet të saj e hoqi pas vetiu.
- 22 Përnjëhere vate pas asaj, posi kau kur vete të theretë, a posi dreri kur këcen ndë lakt,
- 23 Gjersa t'i depërtonjë mushkërinë *ndonjë* shëgjetullë; posi zogu që vete me vrap ndë graçkët, edhe nuk' e di se është kundër jetës's' atij.
- 24 § Tashi pra dëgjo-më-ni, o djem, edhe mba-u-ni vesh fjalëvet të gojësë s'ime.
- 25 Zëmëra jote letë mos priretë mb'udhët t'asaj, as të mos kthenesh mbë rrugat t'asaj.
- 26 Sepse ajo bëri shumë veta të bienë të-plagosurë, edhe *burra* të-fortë janë vrarë prej asaj.
- 27 Shtëpia e asaj është' udhë pise, që shpie poshtë ndër dhomat të vdekjesë.

## Krye 8.

- 1 A nukë thërret dituria? edhe nukë nxjer zën' e saj urtësia?
- 2 Qëndron ndë majët të vëndevet të-lartë përmbi udhët, ndë mest të udhëvet kryqe.
- 3 Thërret afërë portavet, ndë të-hyrët të qytetit, ndë të-hyrët të dyervet:
- 4 § U thërres juve, o njerës, edhe zëri im është mbë të bijt' e njerëzet.
- 5 O të-miturë, kupëtoni urtësi; e ju o të-marrë, fitoni zemërë të-kupëtuarshime.
- 6 Dëgjoni; sepse dotë flas punëra të-larta, edhe buzët' e mia dotë flasënë punëra të-drejta.
- 7 Sepse të-vërtetënë dotë flasë gurmazi im; edhe buzëvet të mia u vjen të-ndohëtë nga pabesëria.
- 8 Gjithë fjalët' e gojës' s' ime janë me drejtëri; ndër ato s'ka kobim a të-shtrëmbërë.
- 9 Të-gjitha janë të-çkoqura tek ay që kupëton, edhe të-drejta ndër ata që gjenjënë dituri.
- 10 Merrni mësimnë t'im, e jo ergjënt; edhe ditjenë, më tepërë se arin' e-sgjedhurë.
- 11 Sepse dituria është më e-mirë se gurët' e-paçëmuarë; edhe gjithë gjërërat' e-dëshëruarshime nukë janë kaqë të-vëjyera sa ajo.
- 12 § Unë dituria rri bashkë me urtësinë, edhe gjenj mëndjen' e këshillavet të-urta.

- 13 Frik' e Zotit është të mërzitnjë njeriu të-keqenë; madhështinë, e gojën' e-vrazhëtë, e udhën' e-keqe, e gojën' e-shtrëmbërë, unë i-mërzit.
- 14 Imja është këshilla, edhë mëndja e-fortë; unë *jam* urtësia; imja është fuqia.
- 15 Me anë t'ime mbretëronjënë mbretëritë, e-dhe të-parëtë bënjënë gjyq të-drejtë.
- 16 Zotërinjtë zotëronjënë me anë t'ime, edhe njerëzit' e-mëdhenj, gjithë gjykatësit' e dheut.
- 17 Unë dua ata që më duanë; edhe ata që më kërkonjënë dotë më gjenjënë.
- 18 Pasja e lavdia është bashkë me mua, gjërërat' e-mira që mbesënë, edhe drejtëria.
- 19 Pemët' e mia janë më të-mira se ari, edhe se ari i-kulluarë; edhe pronjat' e mia, se ergjëndi i-sgjedhurë.
- 20 Ecënj nd' udhët të drejtërisë, ndë mest të rrugavet të gjyqit,
- 21 Që të bënj ata që më duanë te trashëgonjënë të-mira, edhe të mbush thesarët' e a-tyreve.
- 22 § Zoti më kishte ndë kryet t'udhëvet të tia që përpara punëvet të tij, që përpara jetësë.
- 23 Që përpara jetësë më leu *me vaj*, që ndë kryet, para se të jetë dheu.
- 24 Linda, kur nuk' ishinë pafundjetë, kur nuk' ishinë burimetë që buronjën' ujëratë;
- 25 Më parë se të themelosenë maletë, më parë se të jenë kodratë, unë linda;

- 26 Qe kur s'kishte bërë dhenë, as fushatë  
as majat'e dherëravet të botësë.
- 27 Kur bënte gati qiejtë, un' *ishnjam* atje;  
kur shënonte rreth përmbi faqet të pafundjesë;
- 28 Kur qëndronte retë lart; kur forconte bu-  
rimet' e pafundjesë;
- 29 Kur vinte nomin'e tij ndë dett, që ujëratë  
të mos kapërxenjë në urdhëratën' e atij; kur  
shënonte themelet' e dheut;
- 30 Atëhere ishujam për an' ati dyke punuarë;  
edhe unë ishujam përdita shëfrimi *i atij*, e-gë-  
zuarë përherë përpara ati,
- 31 E-gëzuarë ndë botët të dheut t'ati; edhe  
shëfrimi im *ishte* bashkë me bijt'e njerësvet.
- 32 § Tashi pra dëgjo-më-ni, o djem, sepse të-  
lumurë jan' ata që ruanjë në udhët'e mia.
- 33 Dëgjoni mësim, edhe bëhi të-diturë, e-  
dhe mos e hithni tej.
- 34 Lum ay njeri që të më dëgjonjë, dyke  
ndënjurë sguarë përdita ndër dyert të mia,  
ndër pragjet të dyervet të mia.
- 35 Sepse kush të më gjenjë mua, dotë gje-  
një jetë, edhe dotë marrë hir prej Zotit.
- 36 Po kush të fëjenjë kundër meje, i bën  
keq shpirtit të ti; gjith' ata që më mërzi-  
njënë duanë vdekje.

### Krye 9.

- 1 Dituria ndërtoj shtëpin' e saj, latoj të shtatë  
shtyllat' e saj;

- 2 Theri berat' e saj, shtyri verën' e saj, edhe bëri gati truvezën' e saj;
- 3 Dërgoj shërbëtorët' e saj, lëçit mbi vëndet të-lartë të qytetit,
- 4 „Kush është' i-marrë, letë kthenetë këtu;“ edhe atyre që s' kanë mënt u thotë,
- 5 „Ejani, hani nga buka ime, edhe pini nga vera që shtyra.
- 6 „Lini marrëzinë, edhe rroni; edhe ecëni drejt nd' udhët të urtësisë.“
- 7 § Kush mëson përqeshës turpëron vetëhen' e tij; edhe kush qërton njeri të-lik nxin faqen' e tij.
- 8 Mos qërto përqeshës, që të mos të ketë cmir; qërto të-urtinë, edhe dotë të dojë.
- 9 Ep-i *mësim* të-urtit, edhe dotë bënetë m' i-urtë; mëso të-drejtinë, edhe dotë rritetë ndë mësim.
- 10 § Krye e urtësisë *është* frik' e Zotit; edhe të-njohurit' e Shënjtit *është* dituri.
- 11 Sepse me anë t'ime dotë shumonenë ditt' e tua, edhe dotë shtonenë vjett' e jetësë s'ate.
- 12 Ndë ubëfsh i-urtë, dotë jesh i-urtë për vetëhenë t' ende; edhe ndë ubëfsh përqeshës, ti vetëmë dotë vuanjç.
- 13 § Gruaja pa mënt është' e-vrazhëtë, e-marrë, edhe s' di asfare gjëje;
- 14 Rri ndë derët të shtëpis' së saj mbi fron, ndëpër vëndet të-lartë të qytetit,

- 15 Dyke grishur' udhëtarëtë që shkonjënë drejt udhës' së tyre;
- 16 „Kush është' i-marrë, letë kthenetë këtu;“ edhe ati që s' ka mënt i thotë,
- 17 „Ujët' e-vjedhurë ështëë t' ëmbëlë, edhe buk' e-fshehur' është' e-shishme.“
- 18 Po ay nuk' e di, se atje janë të-vdekuritë, edhe ndër të-thellat të pisësë janë të-grishurit' e asaj.

### Krye 10.

- 1 Fjalët' e-urta të Sollomonit.  
Bir' i-urtë gëzon t'anë; po bir' i-marrë ështëë hidhërim i s' ëmësë.
- 2 Thesarët' e paudhërisë s' bënjënë dobi: po drejtëria të shpëton nga vdekja.
- 3 Zoti nukë dotë lërë shpirtin' e të-drejtit të vdesë nga uria; po dëshirën' e të-liqvet e përmbys.
- 4 Dor' e-përtuarë bie vobëzi; po dor' e atij që kujdesetë mbleth pasje.
- 5 Kush mbleth ndë verët është' i bir' i urtësisë; kush fle ndë të-korrët është' i bir' i turpërisë.
- 6 Mbi kryet të të-drejtit janë bekime; po shtrëmbëria mbulon gojën' e të-liqvet.
- 7 I-drejti përmëndetë me bekim; po emëri i të-liqvet dotë kalbetë.
- 8 I-urti nga zemëra dotë presë porosi; po i marri nga buzëtë dotë rrëzonetë.

- 9 Kush ecën drejt ecën inbarë; po kush shtrëmbëron udhët' e tia dotë njihetë.
- 10 Kush bën shënjë me sy bie hidhërim; po i-marri nga buzëtë dotë rrëzonetë.
- 11 Goj' e të-drejtit është burim jete; po shtrëmbëria mbulon gojën' e të-liqvet.
- 12 Cmiri nxjer zënje; po dashuria mbulon gjithë fajetë.
- 13 Ndë buzët të të-mënçurit gjëndetë urtësia; po shkopi është për kurrizin' e atyre që s' kanë mënt.
- 14 Të-urtëtë mbledhënë ditje; po goj' e të-marrit është afërë humbjesë.
- 15 Pasja e të-pasurit është qytet i-fortë për atë; po prishja e të-vobeqvet është vobëzia e atyre.
- 16 Punët' e të-drejtit janë për jetë; puna e të-ligut është për faj.
- 17 Kush ruan mësiminë gjëndetë mb' udhët të jetësë; po kush harron qërtimnë sillet' andej e këtej.
- 18 Kush mbulon cmir ndënë buzë të-rreme, edhe kush nxjer nga goja kallëzim, është i-marrë.
- 19 Ndër fjalë të-shuma nukë shteretë faji; po kush mban buzët' e tia është i-urtë.
- 20 Gjuha e të-drejtit është ergjënt i-sgjedhurë; zemëra e të-liqvet është për mos gjë.
- 21 Buzët' e të-drejtit kullosënë shumë veta; po



- të-marrëtë vdesënë nga të-mos-pasuritë mënt.
- 22 Bekimi i Zotit bën të-pasurë, edhe nd' atë nukë dotë shtonetë hidhërim.
- 23 I-pamënçimi e ka të-bërëtë keq posi lodrë; po urtësia është për njerir' e-mënçim.
- 24 Frika e të-ligut dotë vinjë mbi atë; po dëshërimi i të-drejtëvet dotë mbushetë.
- 25 Sikundrë shkon er' e shakullit, kështu dotë mos qëndronjë i-ligu; po i-drejti dotë qëndronjë ndë jetët të jetësë.
- 26 Posi uthula ndër dhëmbët, edhe tymi ndër syt, kështu është përtesësi tek ata që e dërgonjë.
- 27 Frik' e Zotit shton dit; po vitet' e të-liqvet dotë pakësonenë.
- 28 Shpresa e të-drejtëvet dotë jetë gëzim; po shpresa e të-liqvet dotë humbasë.
- 29 Udh' e Zotit është fortesë te i-pafajmi, po te punëtorët' e paudhërisë *është* humbje.
- 30 I-drejti nukë dotë tundetë ndë jetët të jetëvet; po të-liqtë nukë dotë rrinë mbi dhet.
- 31 Goj' e të-drejtit nxjer urtësi; po gjuha gënjështare dotë këputetë.
- 32 Buzët' e të-drejtit njohën' atë që është e-pëlqyerë; po goja e të-liqvet *njuh* atë që është e-shtrembërë.

## Krye 11.

- 1 Zigareja e-rreme *është* e-ndohëtë te Zoti; po pesha e-drejtë është e-pëlqyerë tek ay.

- 2 Tek hyn madhështia, hyn edhe turpëria; po urtësia *rr*i me të-përunjuritë.
- 3 Të-tërët' e të-drejtëvet dot'u heqë atyre udhënë, po dhelpëria e të-shtrëmbërvet dot' i prishnj' ata.
- 4 Pasja s' bën dobi ndë ditët të zëmërimit; po drejtëria shpëton nga vdekja.
- 5 Drejtëria e njeriut të-tërë dot' j'a bënë udhënë të-drejtë; po i-ligu dotë bjerë për punë të ligësis' së tij.
- 6 Drejtëria e të-drejtëvet dot' i shpëtonj' ata; po të-paudhëtë dotë zihenë ndë të-keqet të tyre.
- 7 Kur vdes njeriu i-lik, shpresa e atij humbetë; humbetë edhe shpresa e të-paudhëvet.
- 8 I-drejti shpëton nga shtrëngata, edhe ndë vëntt t'ati hyn i-ligu.
- 9 Hipokriti me gojënë prish të afërmin' e ti; po të-drejtëtë dotë shpëtonjënë me anë të ditjesë.
- 10 Qyteti gëzonetë, kur venë mbarë të-drejtëtë; edhe gëzonetë, kur prishenë të-liqtë.
- 11 Me bekimn' e të-drejtëvet qyteti lartonetë; po me gojën' e të-liqvet prishetë.
- 12 Ay që s' ka mënt s' e zë për gjë të-afërmin' e tij; po njeriu i-urtë pushon.
- 13 Ay që vete posht' e lart dyke përhapurë fjalë sbulon "fshehësiatë; po ay që është besëtar ndë shpirt fsheh punënë.
- 14 Atje ku nukë ka qeveri të-mirë, gjindja bie; po nga shumica e këshillësvet *vjen* shpëtim.

- 15 Kush bënetë dorë-zënës për tjetërinë, keq dotë pësonjë; po kush ka cmir dorë-zëniën është i-siguruarë.
- 16 Gruaj' e-hieshime fiton nder, edhe të-qëndruarshimitë *ndë punët* fitonjënë pasje.
- 17 Njeriu i-përdëllyershim i bën mirë shpirtit të tij; po i-papërdëllyershimi mundon shpirtin' e tij.
- 18 I-ligu fiton pagë të-rreme; po ay që mbjell drejtëri ka çpagim të-siguruarë.
- 19 Sikundrë drejtëria *suletë* ndë jetët, kështu ay që gjuan të-keqenë *suletë* ndë vdekjet të tij.
- 20 Ata që kanë zëmërë të-shtrëmbërë janë të-ndohëtë te Zoti; po ata që janë faqe-bar dhë ndë udhët *të tyre* janë të-priturë tek ay.
- 21 *Edhe ndë uzëntë* dorë prej dore, i-ligu nukë dotë mbetetë i-pamunduarë; po fara e të-drejtëvet dotë shpëtonjë.
- 22 Gruaja e-bukurë që s' ka mënt është si stoli e-artë ndë turit të derrit.
- 23 Dëshërimi i të-drejtëvet është vetëm' e-mira; po shpresa e të-liqvet është mëria.
- 24 Disa çpërndanjënë, po edhe më tepërë u tepëronjënë; e disa kursenjënë pa masë, po prapë vinjënë ndë skamje.
- 25 Shpirti që bën mirë dotë mahetë; edhe kush ep ujë, dot' i apën' ujë edhe atij.
- 26 Atë që mbyll drithë gjindja dot'a mallëkonjë; po bekim dotë jetë mbi kryet t'ati që e shet.

- 27 Ay që kërkon me kujdes të-mirënë, dotë fitonjë hir; ay që kërkon të-keqenë, *këjo* dotë vinjë mbi atë.
- 28 Kush besonetë mbë pasjet të tij, ky dotë bierë; po të-drejtëtë dotë lulëz-onjënë posi bimë.
- 29 Kush trubullon shtëpin'e tij dotë trashë-gonjë erë; edhe i-marri *dotë jetë* shërbëtuar i të-urtit ndë zëmëret.
- 30 Pem' e të-drejtit; është dru jete; edhe ay që fiton shpirtëra *është* i-urtë.
- 31 Ja, i-drejti çpaguhetë mbi dhet; sa më tepërë i-ligu edhe fajtori!

## Krye 12.

- 1 Kush do qërtimnë, do diturinë; po ay që ka cmir qërtimnë është i-marrë.
- 2 I-miri gjen hir prej Zotit; po atë që mendon të-liga dot' e dënonjë.
- 3 Njeriu nukë dotë jetë ndë siguri me anë të-paudhërisë: po rrënja e të-drejtëvet dotë mbesë e-patundurë.
- 4 Gruaja e-mirë *është* kurorë te burr' i saj; po ajo që bën turpëri *është* kalbësirë ndër eshtrat t' ati.
- 5 Mendimet' e të-drejtëvet janë drejtëri; po këshillat' e të-liqvet janë kobim.
- 6 Fjalët' e të-liqvet janë pritë për gjak; po goj' e të-drejtëvet dot' i shpëtonj' ata.

- 7 Të-liqtë vdirenë e s' janë më, po shtëpia e të-drejtëvet dotë mbesë.
- 8 Njeriu lëvdonetë sipas urtësis' së tij; po i-shtrëmbëri ndë zëmërët dotë jetë për të hedhurë poshtë.
- 9 Më i-mirë është' ay njeri që përunj vetë-henë, e ka shërbëtuar, se ay që mburretë, edhe s' ka bukë të *hajë*.
- 10 I-drejti ka kujdes për jetën' e bagëtis' së tij; po zëmëra e të-liqvet është' e-papërdëllyer-shime.
- 11 Kush punon dhen' e ti dotë nginjetë me bukë; po ay që vete pas *mëndjes'* së njerëzet të-kotë s' ka mënt.
- 12 I-ligu dëshëron gjahun' e të-këqinjvet: po rrënja e të-drejtit ep *pëme*.
- 13 I pabesi zihetë ndë kurth nga faji i buzëvet; po i-drejti shpëton nga shtrëngimi.
- 14 Njeriu dotë mbushetë me të-mira nga pemët' e gojës' së tij; edhe punërat' e duarvet të njeriut dot' i çpaguhenë.
- 15 Udh' e të-marrit *është'* e-drejtë ndër syt t' atij; po ay që dëgjon këshillë *ësh'* i-urtë.
- 16 I-marri dëften përnjëhere zemërimn' e tij; po i-urti mbulon turpjen' e *tij*.
- 17 Kush flet të-vërtetënë rrëfen të-drejtënë; po dëshmimtari i-rrem thotë kobim.
- 18 Ay që flet pa menduarë *ështëë* posi të-pre-rat' e thikësë; po goja e të-urtëvet *ështëë* shërim.
- 19 Buzët' e së-vërtetësë dotë qëndronjënë

- gjithënjë; po gjuha gënjeshtare *është* për një çikëzë herë.
- 20 Kobim është ndë zëmëret t' atyreve që mendonjënë të-liga, po tek ata që këshillonjënë paqtim *është* gëzim.
- 21 Të-drejtit nukë dot' i bënetë ndonjë dëm; po të-liqtë dotë mbushenë me të-këqia.
- 22 Buzëtë gënjeshtare janë ndyrësi te Zoti; po ata që bënëjënë të-vërtetënë *janë* shëfrimi i atij.
- 23 Njeriu i-urtë mbulon ditjen' e tij; po zëmëra e të-marrëvet lëçit marrëzi.
- 24 Dora e të-kujdesuret dot' urdhëronjë; po përtesësitë dotë jenë ndënë urdhërë.
- 25 Hidhërimi ndë zëmëret të njeriut e përunj atë; po fjal' e-mirë e gëzon.
- 26 I-drejti *është* udhë-heqës te i-afërmi i tij; po udh' e të-liqvet i gënjen ata.
- 27 Kush përton nuk' e pjek gjahun' e tij; po gjëja e njeriut të-kujdesurë është shum' e-vëjyerë.
- 28 Nd' udhët të drejtërisë ka jetë, edhe ndër rugët t' asaj nukë ka vdekje.

## Krye 13.

- 1 Djal' i-urtë *dëgjon* mësimn' e t'et; po për- qeshësi nukë dëgjon qërtim.
- 2 Njeriu dotë hajë të-mira nga pemët' e gojës' së tij: po shpirti i të-paudhëvet, mundim.
- 3 Kush ruan gojën' e tij ruan jetën' e ti; po ay që hap gjerë buzët' e ti dotë humbasë.

- 4 Shpirti i ati që përton dëshëron, e s'ka; po shpirti i atyre që janë të-kujdesurë dotë mahetë.
- 5 I-drejti ka cmir fjalën' e-rreme; po i-ligu është' i-qelbur' e i-turpëruarë.
- 6 Drejtëria e ruan atë që është' i-mbarë mb' udhët; po ligësia fajtorinë e hump.
- 7 Ka *njeri* që bën vetëhenë për të-pasurë, e s'ka farë gjëje; e ka njeri që bën vetëhen' e tij për të-vobek, e ka shumë gjë.
- 8 Çpërblimi i shpirtit të njeriut ështëë pasja e atij; po i-vobegu nukë dëgjon të-frikësuarë.
- 9 Drita e të-drejtëvet gëzon; po kandili i të-liqvet dotë shuhetë,
- 10 Nga madhështia del vetëmë zënie; po urtësia ështëë bashkë me ata që marrënë këshillë.
- 11 Gjëja e-fituarë nga kotësira dotë pakësonetë; po ay që mbleth me të-punuarë dotë madhonetë.
- 12 Shpresa që mënohetë e likshton zëmërenë; po të-mbushurit' e dëshirësë ështëë dru jete.
- 13 Ay që heth tej fjalënë dotë humbasë; po ay që i ka frikë porosisë, ky dotë çpaguhetë.
- 14 Nomi i të-urtit ështëë burim jete, që mërgon nga kurthet' e vdekjesë.
- 15 Kupëtim' i-mirë ep hir; po udh' e të-pa-udhëvet është' e-ashpërë.
- 16 Çdo njeri i-urtë punon me mënt; po i-marri sbulon marrëzinë.

- 17 Zë-dhënësi i-keq bie ndë të-keqe; po lajmësi i besësë *është* shërim.
- 18 Vobëzi e turpëri dotë ketë ay që heth tej mësimnë; po ay që ruan qërtimnë dotë ndëronetë.
- 19 Dëshërimi që mbushetë kënaq shpirtinë; po të-marrëvet u vjen të-ndohëtë të prirenë nga e-keqia.
- 20 Ecë me të-urtëtë, edhe dotë jesh i-urtë; po shoku i të-marrëvet dotë thyenjë qafënë.
- 21 E-keqja ndjek fajtorëtë; po të-drejtëtë dotë çpaguhënë me të-mira.
- 22 I-miri u lë trashëgim bijvet të bijvet; po gjëja e fajtorit ruhetë për të-drejtinë.
- 23 Ka shumë ushqim nd' arët të të-vobeqvet; po disa humbasënë nga paudhëria.
- 24 Kush kursen shkopin' e tij ka cmir të birrë; po ay që e do e mundon me kohë.
- 25 I-drejtë ha gjersa t'i nginjetë shpirti; po barku i të-liqvet dotë shteretë.

## Krye 14.

- 1 Çdo grua e-urtë ndërton shëpin' e saj; po e-marra e rëmon me duart' e saja.
- 2 Ay që ecën ndë të-drejtët të tij i ka frikë Zotit; po i-shtrëmbëri nd' udhët të tij s' e zë për gjë atë.
- 3 Ndë gojët të të-marrit është shkopi i madhështisë; po buzët' e të-urtëvet dot' i ruajnën' ata.



- 4 Ku s'ka qe, grazhdetë janë të-pastrëtë;  
po plotësi' e drithit është prej fuqis' së kaut.
- 5 Dëshmimtari i-drejtë nukë dotë gënjenjë;  
po dëshmimtari i-rrem derth gënjeshtërë.
- 6 Përqeshësi kërkon dituri, edhe nukë gjen;  
po për atë që kupëton mësimi është' i-lehtë.
- 7 Largohu që përpara njeriut pa mënt, se-  
pse nukë dotë gjenjç buzë urtësie tek ay.
- 8 Dituria e të-urtit është të njohë udhën'le  
tij; po marrëzia e të-marrëvet është kobim.
- 9 Të-marrëtë qeshnjënë ndë paudhërit; po  
ndë mest të të-drejtëvet ka hir prej Zotit.
- 10 Zëmëra njeh hidhërimn' e saj; edhe i-huaji  
nukë merr pjesë ndë gëzimt t' asaj.
- 11 Shtëpia e të-ligut dotë rrëzonetë; po shtë-  
pia e të-drejtëvet dotë lulëzonjë.
- 12 Ka udhë që i duketë e-drejtë njeriut, po  
fundi i asaj është udhë vdekjeje.
- 13 Edhe ndë të-qeshurit zëmëra ka të-dhëm-  
bura; edhe fundi i gëzimit është hidhërim.
- 14 I-prishuri ndë zëmërët dotë nginjetë nga  
udhët' e tia; po njeriu i-mirë prej vetëhes'  
së tij.
- 15 I-mituri beson çdo fjalë; po i-urti vë re  
ndë çapet të tia.
- 16 I-urti ka frikë, edhe ikën nga e-keqeja;  
po i-marri vete me madhështi dyke ubesuarë  
vetëhesë.
- 17 Ay që zëmëronetë çpejt punon si i-marrë,  
edhe njeriu zëmërë-keq është' i-mërziturë.

- 18 Të-marrëtë trashëgonjënë marrëzi; po të-urtëtë kurorëzonenë me urtësi.
- 19 Të-këqinjhtë bienë mbë gjunjë përpara të-mirëvet; edhe të-liqtë ndë dyert të të-drejtit.
- 20 I-vobegu mërzitetë edhe nga fqinja e tij: po i-pasuri ka shumë miq.
- 21 Kush nukë zë për gjë të-afërmin' e tij fë-jen; po kush përdëllen të-vobeqtë është' i-lumurë.
- 22 A nukë gënjenenë ata që mendonjënë të-ligënë? po përdëllimi edhe e-vërteta dotë jetë ndër ata që mendonjënë të-mirënë.
- 23 Mbë çdo mundim ka fitim; po llomatia e buzëvet bie vetëmë vobëzi.
- 24 Kurorë e të-urtëvet është pasja e atyre; po marrëzia e të-marrëvet është vetëinë marrëzi.
- 25 Dëshmimtari i-vërtetë shpëton shpirtëra; po i-rremi derth gënjeshtër.
- 26 Ndë frikët të Zotit ka besim të-fortë; edhe bijt' e ati dot'a kenë pëtetje.
- 27 Frik' e Zotit është burim jete, që mërgon nga kurthet' e vdekjesë.
- 28 Ndë shumicët të gjindjesë është lavdia e mbretit, po ndë të-pakësuarët të gjindjesë është prishja e atij që zotëron.
- 29 Ay që zëmëronetë vonë është *njeri* me urtësi të-madhe; po ay që zëmëronetë çpejt tregon shumë marrëzi.
- 30 Zëmër' e-prëjturë është jet' e trupit; po cmiri është kalbësir' e eshtëravet.

- 31 Kush shtrëngon të-vobegunë çpërnderon Bërësin' e atij; po ay që e përdëllen të-vobegunë e nderon Atë.
- 32 I-ligu dotë përmbysëtë për punërat' e tij të-liga; po i-drejti *edhe* ndë vdekjet të tij ka shpresë.
- 33 Ndë zëmërët të të-mënçurit prëhet' urtësi; po ajo që është përbrënda ndë të-marrët dotë çpërfaqetë.
- 34 Drejtëria larton komp; po faji është turpje gjëndjesh.
- 35 Mbreti e ka mbë sy të-mirë shërbëtorin' e-urtë; po zëmërim' i atij është mb' atë që bën turpëri.

## Krye 15.

- 1 Të-përgjegjurit' e-ëmbëlë e sbut zëmërimnë; po fjal' e-hidhurë e ndes zëmërimnë.
- 2 Gjuh' e të-urtëvet e sbukuron diturinë; po goj' e të-marrëvet gromësin marrëzi.
- 3 Syt' e Zotit *janë* mbë çdo vënt dyke shikuarë të-këqinjt' e të-mirëtë.
- 4 Gjuh' e-ëmbëlë është dru jete; po e-shtrëmbëra *është* të-thyerë fryme.
- 5 I-marri heth poshtë mësimn' e t' et; po ay që ruan qërtim është i-urtë.
- 6 Ndë shtëpit të të-drejtit ka shumë thesarë; po ndë pronjët të të-ligut trubullim.
- 7 Buzët' e të-urtëvet përndanjënë mënt; po zëmëra e të-marrëvet nuk' është kështu.

- 8 Kurbani i të-ligut është ndyrësi te Zoti;  
po lutja e të-drejtëvet është gëzim tek Ay.
- 9 Udh' e të-ligut është ndyrësi te Zoti; po  
do atë që vete pas drejtërisë.
- 10 Ka mundim të-keq për atë që lë udhënë;  
ay që mërzit qërtimnë, dotë vdesë.
- 11 Hadhi edhe humbja janë përpara Zotit;  
sa më tepërë zëmërat' e bijvet të njerëzet?
- 12 Përqeshësi nukë do atë që e qërton, as  
nukë do të vejë te të-urtëtë.
- 13 Zëmër' e-gëzuarë e bën të-qeshurë faqe-  
në; po nga hidhërimi i zëmërësë shtrëngo-  
netë fryma.
- 14 Zëmëra e atij që kupëton kërkon dituri;  
po goja e të-marrëvet kullot marrëzi.
- 15 Gjithë ditt' e të-helmuarit janë të-këqia;  
po kush ka zëmërë të-gëzuarë ka gjithënjë  
gosti.
- 16 Më mirë e-paka me frikë të Zotit, se  
shumë thesarë e trubullim ndër ata.
- 17 Më mirë një gosti lakrash me dashuri, se  
një viç i-ushqyerë me çmir.
- 18 Njeriu zëmërak ndes luftëra; po zëmërë-  
gjeri pushon zënie.
- 19 Udh' e përtësësit është si e-thururë me  
ferra; po udh' e të-drejtëvet është e-sheshuarë.
- 20 Bir' i-urtë e gëzon t'anë; po njeriu i-ma-  
rrë përqesh t'ëmënë.
- 21 Marrëzia është gëzim tek ay që s' ka mënt'  
po njeriu i-mënçim ecën drejtë.

- 22 Tek s'ka këshillë, mendimetë dalënë të-kotë; po tek janë shumë këshillës forconenë.
- 23 Njeriu ka gëzim ndë të-përgjegjurit të gojës'së tij; edhe një fjalë ndë kohët që duhetë sa e-mirë është!
- 24 Te i-mënçuri udh'e jetësë është drejt për-pjetë, që të prapsetë nga hadhi poshtë.
- 25 Zoti prish shtëpin' e madhështorëvet; po forcon kufin' e së-vesë.
- 26 Mendimet' e të-ligut janë ndyrësi te Zoti; po fjalët' e të-kthjellëvet janë të-pëlqyera.
- 27 Mitëmarrësi trubullon shtëpin'e tij; po kush mërzit mitatë dotë rronjë.
- 28 Zëmëra e të-drejtit mendonetë, pa përgjigjetë; po goja e të-paudhëvet gromësin të-këqia.
- 29 Zoti është lark nga të-liqtë; po dëgjon lutjen' e të-drejtëvet.
- 30 Drit' e syvet gëzon zëmërënë; edhe zër' i-mirë man eshtëratë.
- 31 Veshi që dëgjon qërtimin' e jetësë gjendetë ndër të-urtët.
- 32 Kush heth tej mësimnë ka cmir shpirtin' e tij; po kush dëgjon qërtimnë, fiton mënt.
- 33 Frik'e Zotit është mësim diturie; edhe të-përunjuritë shkon përpara lavdisë.

### Krye 16.

- 1 Të-gatiturat' e-zëmërësë jan *pun'* e njeriut; po të-përgjegjurit' e gjuhësë është prej Zotit.

- 2 Gjithë udhët' e njeriut janë të-qëruara ndër syt t' atij; po Zoti peshon frymatë.
- 3 Var-i punët' e tua te Zoti, edhe mendimet' e tu dotë forconenë.
- 4 Zoti bëri çdo gjë për qëllimet' e tij; po edhe të-ligunë për ditën' e-keqe.
- 5 Çdo madhështuar ndë zëmërët është ndyrësi te Zoti; edhe ndë uzëntë dorë prej dore, nukë dotë mbetetë pa mundim.
- 6 Me përdëllim e me të-vërtetë qëronetë paudhëria; edhe me anë të frikës' së Zotit njerëzitë hiqenë nga e-keqja.
- 7 Kur i pëlqenjënë Zotit udhët' e ndonjë njeriu, paqton me atë edhe armiqt' e atij.
- 8 Më mirë pak me të-drejtë, se shumë pronja me paudhëri.
- 9 Zëmëra e njeriut mendon udhën' e atij; po Zoti drejton çapet' e atij.
- 10 Vendim Perëndie është ndër buzët të mbretit; goja e atij nukë fëjen ndë gjyqt.
- 11 Pesha e-drejtë edhe zigare janë të Zotit; gjithë peshat' e thesit janë pun' e atij.
- 12 Është ndyrësi mbretëritë të punonjënë ligësi; sepse froni forconetë me drejtëri.
- 13 Buzët' e-drejta janë shëfrimi i mbretërvet, edhe duan' atë që flet drejtë.
- 14 Zëmërimi i mbretit është zëdhënësi i vdekjesë; po njeriu i-urtë e sbut atë.
- 15 Ndë dritët të faqes' së mbretit është jetë;

edhe sy i-mir'i ati është posi rej'e shiut tëvonëtë.

16 Sa më mirë është të fitonjë *njeriu* dituri se ar! po, më mirë është të fitonjë urtësi se ergënt.

17 Udh'e të-drejtëvet është të prapsenë nga e-keqja; kush ruan udhën'e tij ruan jetën'e tij.

18 Madhështia shkon përpara prishjesë; edhe të-mbajturit'e shpirtit mbë të-math shkon përpara rëniesë.

19 Më mirë të jetë njeriu i-përunjurë bashkë me të-vobeqtë, se të ndanjë plaçka bashkë me madhështorëtë.

20 Ay që vë re ndë fjalët dotë gjenjë mirë; edhe kush besonetë mbë Zotinë është i-lumurë.

21 Ay që është i-mënçurë ndë zëmërët dotë quhet' i-urtë; edhe ëmbëlsira e buzëvet shton mësim.

22 Urtësia është burim jete tek ay që e ka atë; po mësimi i të-marrëvet është marrëzi.

23 Zëmëra e të-urtit urtëson gojën'e atij, edhe shton mësim ndër buzët t' atij.

24 Fjalët' e-pëlqyera janë hoj mjalte, ëmbëlsirë ndë shpirt, edhe shërim ndër eshtërat.

25 Ka udhë që i duketë njeriut e-drejtë, po fundi i asaj është' udhë vdekjeje.

26 Shpirti i ati që punon, punon për vetëhen' e tij; sepse goja e atij e shtrëngon atë.

27 Njeriu që s'ka punë rëmom të-keqe; edhe ndër buzët t' atij është posi zjarr që djek.

- 28 Njeriu i-shtrëmbërë mbjell zënie; edhe pishtëllinjësi ndan më të-dashuritë miq.
- 29 Njeriu shtrëngatës gënjen të-afërmin' e tij, edhe e shpie mb' udhët që s' është' e-mirë;
- 30 Kur mbyll sytë, mendonetë të gjenjë punë të-shtrëmbëra; dyke kafshuarë buzëtë, të-këqia.
- 31 Flokët' e-sbardhurë janë kurorë lavdie, kur gjëndenë mb' udhët të drejtërisë.
- 32 Kush ështëë i-mënuarë ndë zëmërimt ështëë më i-mirë se i-forti; edhe ay që urdhëron shpirtin' e tij *më i-mirë* se ay që merr një qytet.
- 33 Shorta hidhetë ndë kuletët; po gjithë gjyqi i asaj ështëë nga Zoti.

## Krye 17.

- 1 Më mirë një copë *buke* së-thatë e paqtim bashkë me atë, se një shtëpi plot me kurbanë bashkë me zënie.
- 2 Shërbëtori i-urtë dotë urdhëronjë birinë që bën turpje, edhe dotë ketë pjesë ndë trashëgimt ndë mest të vëllezëret.
- 3 Sqyreja që tret çprovon ergjëndinë, furra arinë, po Zoti zëmëratë.
- 4 Keqbërësi dëgjon buzët' e-paudha; gënjeshitari i mban vesh gjuhës' së-ligë.
- 5 Kush përqesh të-vobegunë, shan Bërësin' e ati; kush gëzonetë ndë të-ligat nukë dotë mbëtetë i-pamunduarë.



- 6 Kurora e pleqvet janë bijt' e bijvet; edhe lavdia e bijvet janë prindërit' e atyre.
- 7 Fjalë të-larta nuk' i kanë hije të-marrit; shumë më pak buzët' e-rreme *nuk' i kanë hije* zotënisë.
- 8 Mita është *posi* gur i-paçëmuarë ndër syt të mitëmarrësit; ngado që të kthenetë, mbaron punë.
- 9 Kush mbulon faj kërkon dashuri; po kush e merr ndëpër gojë punënë, ndan më të-dashuritë miq.
- 10 Një qërtim rreh të-kupëtuarshiminë më tepërë se një qint frushkulla të-marrinë.
- 11 I-ligu kërkon vetëmë trubullime; përاندaj dotë dërgonetë zëdhënës i-keq kudr' atij.
- 12 Letë pıqetë me njerinë harusha që i kanë marrë të-vegjëlit' e asaj, po jo i-marri ndë marrëzit të tij.
- 13 Kush çpagan të-keqe ndë vëntt të sëmirësë, e-keqeja s' është për të hequrë nga shtëpi' e atij.
- 14 Të-nisurit' e zëniesë gjan me të-lëshuarët' e ujëravet; përاندaj pusho nga qarta përpara se të ndizetë.
- 15 Kush nxjer të-pafajm të-ligunë, edhe kush dënon të-drejtinë, që të dy janë ndyrësi te Zoti.
- 16 Ç'vëjen ergjëndi ndë dorë të të-marrit, që të blerë dituri, kur ay s'ka mënt?

- 17 Miku *të* do kurdo, po vëllaj lint për kohën' e nevojësë.
- 18 Njeriu që s'ka mënt ep dorë, edhe bënë netë dorëzënës për mikun' e tij.
- 19 Kush do qarta do faje; kush larton fort derën' e tij kërkon prishje.
- 20 Kush ka zëmërë të-shtrëmbërë nukë gjen të-mirë; edhe kush ka gjuhë të-shtrëmbërë bie ndë të-keqe.
- 21 Kush pjell të-marrë *e pjell* për helm të tij; edhe i ati i të-marrit s' sheh gëzim.
- 22 Zëmër' e-gëzuarë bën mirë posi mjekësi; po shpirti i-helmuarë than eshtëratë.
- 23 I-ligu merr dhuratë nga gjiri, për të shtrëmbëruar' udhët' e gjyqit.
- 24 Përpara faqes' së të-kupëtuarshimit ka urtësi; po syt' e të-marrit janë mb'anët të dheut.
- 25 Bir' i-marrë është helm tek i ati, edhe hidhërim tek ajo që e ka pjellë.
- 26 Nuk' është mirë t'i vihetë mundim të-drejtit, as t'u bjerë njeriu të-fisçimvet për drejtërin' e *atyre*.
- 27 Kush kursen fjalët' e tij është i-mënçim; zëmërë-gjeri është njeri i-urtë.
- 28 Edhe i-marri, kur s' flet, numëronetë për i-urtë; edhe ay që mbyll buzët' e tij është i-mënçim.

## Krye 18.

- 1 Ay që ndahetë kërkon pas dëshërimit të tij, *edhe* tërbonetë kundrë çdo urtësie së-fortë.
- 2 Të-marrit nuk' i pëlqen urtësia, po vetëmë ç'mendon zëmër' e atij.
- 3 Kur vjen i-ligu, vjen edhe qarta; edhe bashkë me të-sharëtë edhe turpëria.
- 4 Fjalët' e gojës' së njeriut janë ujëra të-thella; burim' i diturisë është posi përrua që rrieth.
- 5 Nuk' është mirë t'i mbanjë krahë *njeriu* të-ligut, për të përmbysurë të-drejtinë ndë gjyqt.
- 6 Buzët' e të-marrit hynjënë ndë grindje, edhe goja e atij gërshet shuplaka.
- 7 Goj' e të-marrit është prishja e atij; edhe buzët' e atij janë dhokan për shpirtin' e atij.
- 8 Fjalët' e pishtëllonjësit janë si kafchita t'ëmbëla, edhe sbresënë *gjer* ndë të-përbrëndëshmet anë të barkut.
- 9 Ay që përton ndë punët të tij është i vëllaj i plankprishësit.
- 10 Emëri i Zotit është pirk i-fortë; i-drejti suletë tek ay, edhe është ndë siguri.
- 11 Pasja e të-pasurit është qytet' i atij i-fortë, edhe e pandeh për mur të-fortë.
- 12 Përpara prishjesë lartonetë zëmëra e njeriut, edhe përpara lavdisë shkon të-përunjuritë.

- 13 Të përgjigjetë *njeriu* më parë se të dëgjonjë është marrëzi e turpëri për atë.
- 14 Fryma e njeriut dotë forconjë dobësirën' e atij; po frymënë që është ndë shtrëngim kush munt t'a ngrerë?
- 15 Zëmëra e të-mënçurit fiton ditari, edhe veshi i të-urtet kërkon ditje.
- 16 Dhurata e njeriut hap vënt për atë, edhe e bie atë përpara të-mëdhenjvet.
- 17 Ay që flet më përpara ndë gjyqt të tij *duket'* i-drejtë, po vjen kudrëgjyqësi i ati edhe e vëzhgon atë.
- 18 Shorta shkurton qartatë edhe vendos ndër mest të të-fortëvet.
- 19 *Më rëndë është të sbutetë një vëlla* i zëmëruarë se *të shtihetë ndë dorë* një qytet i-fortë; edhe të-këtilla qarta janë posi loze pirgu.
- 20 Barku i njeriut dotë nginjetë nga pemët' e gojës' s' atij; nga pronjat' e buzëvet t' atij dotë mbushetë.
- 21 Vdekja edhe jeta janë ndë fuqit të gjuhësë; edhe ata që duan' atë dotë hanë nga pemët' e asaj.
- 22 Kush gjeti grua gjeti gjë të-mirë, edhe fitoj hir nga Zoti.
- 23 I-vobegu flet *me* të-lutura; po i-pasuri përgjigjetë me të-vrazhëtë.
- 24 Kush hën shumë miq *i bën* për prishjen' e tij; po ka mik më të-dashurë *edhe* se vëllaj

## Krye 19.

- 1 Më i-mirë është' i-vobegu që ecën ndë të-tërët të tij, se ay që është' i-shtrëmbërë ndë buzët të tia edhe është' i-marrë.
- 2 Shpirt pa mënt me të-vërtetë nuk ështëë gjë e-mirë, edhe kush nxiton me këmbëtë fëjen.
- 3 Marrëzia e njeriut përmbys udhën' e atij; edhe zëmër' e atij nurmuris kundrë Zotit.
- 4 Pasja shton shumë miq; po i-vobegu lihetë *edhe* prej mikut të tij.
- 5 Dëshmimtari i-rrem nukë dotë mbetetë pa munduarë; edhe kush flet gënjeshtër nukë dotë shpëtonjë.
- 6 Shumë përkëdheljnë faqen' e dorë-hapëtis; edhe çdo njeri ështëë mik i atij që ep dhurata.
- 7 Të-vobegunë e mërzitnjënë gjithë të vëllëzëritë; sa më tepërë dotë mërgonenë nga ay miqt' e ati? Ay vete pas dyke luturë, *po* ata nukë *përgjigjenë*.
- 8 Kush fiton dituri do shpirtin' e tij; kush ruan urtësi dotë gjenjë mirë.
- 9 Dëshmimtari i-rrem nukë dotë mbetetë pa munduarë; edhe kush flet gënjeshtër dotë vdiqetë.
- 10 Kënaqja nuk' i ka hie të-marrit; shumë më pak njëj shërbëtori të urdhëronjë zotërinë.
- 11 Urtësia e njeriut e bën atë të zëmëronetë

- vonë; edhe është lavdi për atë të mos e shikonjë faj në *që i bën jënë*.
- 12 Zëmërimi i mbretit është posi ulërimë leoni; po dashuria e atij është posi vesa mbi barinë.
- 13 Bir' i-marrë është mjerësi për t'anë; edhe zëniet' e gruasë janë si pika që s'pushon.
- 14 Shtëpi e pasje janë trashëgim nga atëritë; po gruaja e-mirë nga Zoti.
- 15 Përtimi heth njerinë ndë gjumë të-rëndë; edhe shpirti përtac dotë ketë uri.
- 16 Kush ruan porosinë ruan shpirtin' e tij; po ay që nukë ka kujdes ndë udhët të tia dotë vdesë.
- 17 Kush përdëllen të-vobegunë huan Zotinë, edhe punën' e-mirë Ay dot' j'a çpaganjë.
- 18 Mundo t'ët bir gjersa është shpresë; po letë mos të ndizetë shpirti, gjersa t'a vraç atë.
- 19 Zëmëraku i-keq dotë heqnjë mundim; sepse edhe ndë e lirofsh atë, përsëri duhetë t'a bësh atë *punë*.
- 20 Dëgjo këshillë e prit mësim, që të bënesh i-urtë ndë *ditt* t'ënde të fundit.
- 21 Shumë mendime ka ndë zëmëret të njeriut; po këshilla e Zotit, ajo dotë qëndronjë.
- 22 Ajo që e bën njerinë të duhetë është mirësi' e atij; edhe i-vobegu është më i-mirë se gënjeshtari.
- 23 Frik' e Zotit *shpie* ndë jetët, edhe *ay që e ka* dotë jet' i-kënaqurë; ndonjë e-keqe s'e ka për të gjeturë.

- 24 Ay që përton ngjyen dorën' e tij ndë kupët, edhe nukë do t'a kthenjë as ndë gojë të tij.
- 25 Rrih përqeshësinë, edhe i-mituri dotë bënet' i-mënçurë; edhe qërto të-kupëtuarshiminë, edhe dotë kupëtonjë dituri.
- 26 Kush përdor ashpërë t'anë, e shtyn t'ëmënë, është bir që bie turpëri e të-sharë.
- 27 Pusho, o biri im, së dëgjuari mësim që të praps nga fjalët' e diturisë.
- 28 Dëshmimtar' i-paudhë përqesh të-drejtënë; edhe goja e të-liqvet përpin paudhëri.
- 29 Gjyqe bënenë gati për përqeshësitë, edhe të-rrahura për kurrizin' e të-marrëvet.

## Krye 20.

- 1 Vera është përqeshëse, edhe të-pirët' efortë bie qarta; edhe kush gënjenetë nga këto nuk' është' i-urtë.
- 2 Të-zëmëruarët' e mbretit është posi ulurimë leoni; kush e zëmëron atë fëjen kundër jetës' së tij.
- 3 Nder për njerinë është të'hiqetë nga qarta; po çdo i-marrë bie qarta.
- 4 Ay që përton nukë do të lëronjë nga pun' e dimërit; përandaj dotë lypënjë ndë kohët të të-korravet, edhe nukë dotë gjenjë.
- 5 Këshilla ndë zëmëret të njeriut është posi ujëra të-thella; po njeriu i-mënçim dot' e nxjerrë atë.

- 6 Shumë njerës lëçisnjënë sicili mirësin' e tij;  
po njeri besëtar kush munt të gjenjë?
- 7 I-drejti ecën ndë të-tërët të tij; edhe të  
bijtë pas ati janë të-lumurë.
- 8 Mbreti që rri mbi front të gjyqit çpërndan  
me syt' e tij çdo të-keqe.
- 9 Kush munt të thotë, Qërova zëmërënë t'ime,  
jam i-qëruarë nga fajet' e mi?
- 10 Dy farë peshash e dy farë masash, që  
të dy *palëtë* gjithashtu janë ndyrësi te Zoti.
- 11 Edhe djali vetë njihetë nga punët' e tia,  
ndë janë punët' e atij të-qëruara, edhe ndë  
janë të-drejta.
- 12 Veshinë që dëgjon, edhe syrinë që sheh,  
Zoti i ka bërë që të dy.
- 13 Mos duaj gjumënë, që të mos bënesh i-  
vobek; hap syt' e tu, *edhe* dotë nginjesh me  
bukë.
- 14 E-ligë, e-ligë, thotë blerësi; po si të ikë-  
një, mburretë.
- 15 Ka ar, edhe shumicë margaritarësh; po  
buzët' e-urta janë stoli e-paçëmuarë.
- 16 Merr rrobën' e atij që bënetë dorë-zënës  
për të-huajnë; edhe merr peng prej *atij që  
bënetë dorë-zënës* për të-huajtë.
- 17 Buk' e gënjeshtresë është' e-ëmbëlë te-nje-  
riu, po pastaj goj' e atij dotë mbushetë me  
haliqë.
- 18 Mendimetë forconenë me anë të këshillë-  
së; edhe si të mendonesh mirë, bëj luftë.



- 19 Ay që vete posht' e iart e përndan fjalë  
sbulon fshehësira; përandaj mos upërzje ba-  
shkë me atë që sgjeron buzët' e tia.
- 20 Kandilej' e atij që shan t'an' e t'ëmënë  
dotë shuhetë nd' errësirë të-thellë.
- 21 Trashëgimi, që është fituarë me të-çpejtë  
ndë kryet të herësë, nukë bekonetë ndë funtt.
- 22 Mos thuaj, Dotë çpajuanj të-keqenë; be-  
sohu mbë Zotinë, edhe dotë të shpëtonjë.
- 23 Pesha të-ndryshme janë ndyrësi te Zoti;  
edhe zigarej' e-gënjeshtretë nuk' ësh' e-mirë.
- 24 Çapet' e njeriut janë prej Zotit; qysh pra  
munt njeriu të kupëtonjë udhën' e tij?
- 25 Është dhokan për njerinë të flasë vrazhëtë  
për *punërat'* e-shënjtëruara, edhe pas kushti-  
mevet të bënjë të-pyetura.
- 26 Mbreti i-urtë heth tej të-liqtë, edhe kthen  
rrotovilenë mbi ata.
- 27 Kandil' e Zotit është frym' e njeriut që  
vëzhgon gjithë të-thellat' e zëmëresë.
- 28 Përdëllimi edhe e-vërteta ruanjënë mbretinë;  
edhe fron' i atij forconetë me përdëllim.
- 29 Lavdia e të-rinjvet është fuqi' e atyreve,  
edhe nderi i pleqvet është kok' e-sbardurë.
- 30 Frushkullatë që plagosnjënë qëronjënë të-  
ligënë; *kështu* edhe të-rrahuratë që arinjënë  
gjer ndë të-pëbrëndëshmet të barkut.

## Krye 21.

- 1 Zëmëra e mbretit është ndë dorët të Zotit

posi rrëket' e ujëravet; ku të dojë, e kthen atë.

2 Gjithë udhët' e njeriut janë të-drejta ndër syt t' atij; po Zoti peshon zëmëratë.

3 Të bënjë njeriu drejtëri e gjyq është më e-pëlqyerë *gjë* te Zoti se kurbanit.

4 Syr' i-lartë, e zëmëra madhështore, e drit' e të-liqvet, janë faj.

5 Mendimet' e të-kujdesurit *shpienë* vetëmë ndë plotësi, po t' atij që çpejton ndë skamje.

6 Të gjenjë njeriu thesarë me gjuhë të-rremë është *posi* një avull që shpihetë andej këtej; ata *që kërkonjënë ata* kërkonjënë vdekje.

7 Të-këqiat' e të-liqvet dot' i humbasnjën' ata; sepse s' duanë të bënjënë të-drejtënë.

8 Udh' e njeriut të-prishurë *është* me të-tepërë e-shtrëmbërë; po sa për të-qëruarinë, udh' e atij është' e-drejtë.

9 Më mirë të rrijë njeriu ndë një çip të mbulesës' *së shtëpisë*, se ndë shtëpi të-gjerë me grua që do zënie.

10 Shpirti i të-paudhit dësëron të-ligënë; i-afërm' i atij nukë gjen hir ndë syt t' atij.

11 Kur mundonetë përqeshësi, i-mituri bënetë i-urtë; edhe i-urti, kur mësonetë, nxë mënt.

12 I-drejti mendonetë për shtëpin' e të-ligut, kur të-liqtë përmbysenë ndë humbjet *të tyre*.

13 Kush zë veshët' e tij ndë klithmët të të-vo-begut, dotë këlthasë edhe ay, po nukë dotë dëgjonetë.

- 14 Dhurat' e-fshehurë sbut zëmëratë; edhe dhurëtia ndë gji *sbut* mëri të-fortë.
- 15 Është gëzim për të-drejtinë të bënjë gjyq; po *këjo* është prishje për punëtorët' e paudhërisë.
- 16 Njeriu që del jashtë nga udh' e urtësisë ka për të ndënjurë ndë mbledhjet të të-vdekuret.
- 17 Kush do shëfrim dotë bënetë i-vobek; kush do verë e vaj nukë dotë bënet' i-pasurë.
- 18 I-ligu dotë jetë çpërblim për të-drejtinë, edhe i-paudhi për zëmërë-drejtëtë.
- 19 Më mirë të rrijë njeriu ndë dhe të-shkretë se me grua grindare e zëmërake.
- 20 Thesar të-paçëmuarë edhe vaj ka ndë shtëpi të të-urtit; po njeriu i-marrë i kollofit ato.
- 21 Kush vete pas drejtëris' e pas përdëllimit dotë gjenjë jetë, drejtëri, edhe lavdi.
- 22 I-urti hipën e merr qytetin' e të-fortëvet edhe rrëzon fuqinë, mbë të-cilënë besonenë.
- 23 Kush ruan gojën' e tij e gjuhën' e tij ruan shpirtin' e tij nga shtrëngimetë.
- 24 Njeriu madhështuar e krye-lartë quhetë përqeshës; ay punon me zëmërim e me madhështi.
- 25 Dëshërim' i përtesësit e vret atë; sepse duart' e atij nukë duanë të punonjënë.
- 26 Gjithë ditënë dëshëron dëshërimë me të-tepërë; po i-drejti ep edhe s' kursen.
- 27 Kurhani i të-liqvet është ndyrësi; sa shumë më tepërë kur bënetë me qëllim të-lik!

- 28 Dëshimtari i-rrem dotë vdirotë; po njeriu që bindetë dotë flasë pa frikë.
- 29 Njeriu i-lik ashpëron faqen' e tij; po i-drejti drejton udhët' e tia.
- 30 S' ka as urtësi, as dituri, as këshillë kundrë Zotit.
- 31 Kali bënetë gati për ditën' e luftësë; po shpëtimi është prej Zotit.

## Krye 22.

- 1 Më mirë të *kesh* emërë të-*mirë* se pasje të-mëdha, e hir të-*mirë* se ergjënt e ar.
- 2 I-pasuri e i-vobegu pîqenë bashkë; Zoti është bërësi i këtyre të dyve.
- 3 I-urti sheh të-ligënë, edhe fshihetë; po të-marrëtë shkonjë në përpara edhe mundonenë.
- 4 Çpagimi i përuntjesë e i frikës' së Zotit është pasje, e lavdi, e jetë.
- 5 Driza e dhokanë janë mb' udhët të të-shtrëmbërit; kush ruan shpirtin' e tij dotë jetë lark nga ato.
- 6 Mëso djalënë ndë të-nisurit t' udhës' s' atij, edhe nukë dotë largonetë nga ajo, as kur të plaketë.
- 7 I-pasuri urdhëron të-vobeqtë; edhe ay që huhetë është shërbëtuat i atij që huan.
- 8 Kush mbjell paudhëri dotë korrnjë mjerrësi; edhe shkopi i zëmërimit t' atij dotë rrëzonetë.

- 9 Kush ka sy mirëbërës dotë bekonetë; sepse prej bukës' së tij i ep të-vobegut.
- 10 Dëbo përqeshësinë, edhe dot' ikënjë qarta; po, të-zënët' edhe të-sharëtë dotë pushonjëne.
- 11 Sa për atë që do të-qëruarët' e zëmërësë, për hirin' e buzëvet t'atij mbreti dotë jetë mi-ku i atij.
- 12 Syt' e Zotit ruanjëne atë që ka urtësi; po fjalët' e të-paudhit i përmbys.
- 13 Kush përton thotë, Leon është jashtë; dotë vritem ndë mest të rrugavet.
- 14 Goja e gruas' së-huaj është grop' e-thellë; ay të-cilinë Zoti e mërzit dotë bjerë brënda nd' atë.
- 15 Marrëzia është lidhurë bashkë me zëmë-rën' e çunit; shkopi i mundimit dot' e ndanjë atë prej atij.
- 16 Kush shtrëngon të-vobegunë për të shtuarë *pasjen'* e tij, edhe kush i ep të-pasurit, pa fjalë dotë vinjë ndë nevojë.
- 17 Ş. Vërë veshnë, edhe dëgjo fjalët' e të-urtëvet, edhe ngjit zëmërënë t'ënde pas ditjesë s'ime;
- 18 Sepse është pun' e-pëlqyerë, ndë i ruajç ndë zëmëret t'ënde, edhe ndë qëndrofshinë bashkë mbi buzët të tua.
- 19 Që të jetë të-besuarëtë t'ënt mbi Zotinë, të mësova *këto* këtë ditë, po, tyj.
- 20 A nukë të shkrova ty shumë herë me

- 21 këshillë e me mënt, që të të bënj të njohç  
sigurin' e fjalëvet të së-vërtetësë, që t'u biesh  
fjalë të-vërteta atyreve që të dërgonjënë ty?
- 22 Mos svish të-vobegunë, sepse është' i-vo-  
bek; as mos shtrëngo ndë portët fat-keqinë;
- 23 Sepse Zoti dotë vështronjë gjyqin' e aty-  
reve; edhe dotë sveshnjë shpirtin' e atyreve  
që sveshn' ata.
- 24 Mos ki miqësi me njeri zëmërak; as mos  
ecë bashkë me njeri zëmërak;
- 25 Semos nxësh udhët' e atij, edhe gjesh kurth  
për shpirtinë t'ënt.
- 26 Mos jij nga ata që apënë dorë, nga ata  
që bënenë dorëdhënës për detyrë.
- 27 Ndë mos paç të paguanjç, përse të të  
marrënë shtratinë t'ënt që përposh teje?
- 28 Mos luaj nga vëndi kufinj të-vjetërë që  
kanë vënë atërit' e tu.
- 29 A sheh njeri që ështëë i-kujdesurë ndë  
punërat të tia? ay dotë qëndronjë përpara  
mbretërve; nukë dotë qëndronjë përpara të-  
poshtërve.

### Krye 23.

- 1 Kur të rrish të hash bashkë me bujar,  
vështro mirë ato që kanë vënë përpara teje;
- 2 Edhe vër' i thikë qafësë s' ate, ndë je shu-  
mëhamës.
- 3 Mos dëshëro gjellët' e atij të-shishme; se-  
pse këto janë të-ngrëna kobimi.

- 4 Mos upërpiq të bënesh i-pasurë; hiq dorë prej mëndjesë s' ate.
- 5 A do të shtjesh sytë mb'atë gjë që s' është? sepse *pasja* bën me të-vërtetë krahë për vetëhen' e saj, e fluturon ndë qiellit posi shqiponjë.
- 6 Mos ha bukën' e atij që ka syn' e-keq, as mos dëshëro gjellët' e atij të-shishme;
- 7 Sepse sikundrë mendon ndë zëmëret të tij, i-këfillë është; Ha e pi, të thotë ty; po zëmër' e atij nuk' është bashkë me ty.
- 8 Kafshitënë që hëngre dot' e vjellç, edhe dotë humbaç ligjëratat' e-ëmbëla.
- 9 Mos folë, kur të dëgjon *ndonjë* i-marrë; sepse dotë hedhë poshtë urtësin' e fjalëvet të tua.
- 10 Mos luaj nga vëndi kufinj të-vjetërë; edhe mos hyrë nd' arët të të-varfërvet;
- 11 Sepse Çpërblimtar' i atyre është i-fortë; ay dotë shikonjë gjyqin' e atyre kundrë teje.
- 12 Ngjit zëmërenë t'ënde pas mësimit, edhe veshët' e tu pas fjalëvet të urtësisë.
- 13 Mos ukurse të mundosh djalënë; sepse ndë i rënç atij me shkop, nukë dotë vdesë.
- 14 ' Dot'a rrahç atë me shkop, po dot' i shpëtonjë shpirtinë nga hadhi.
- 15 Biri im, ndë ubëftë zëmëra jote e-urtë, dotë gëzonet' edhe zëmëra ime;
- 16 Po, edhe veshnjat' e mia dotë gëzonenë, kur të flasënë buzët' e tua gjërëra të-drejta.

- 17 Zëmëra jote letë mos u ketë zili fajtorëvet; po ki frikë Zotit tërë ditënë;
- 18 Sepse me të-vërtetë ka çpagim, edhe shpresa jote nukë dotë këputetë.
- 19 § Dëgjo ti, o biri im, edhe bënu i-urtë, edhe drejto zëmërënë t'ënde mb'udhët të-*mirë*.
- 20 Mos rri bashkë me verëpirës, as bashkë me shumëhamës që hanë mish;
- 21 Sepse verëpirësi edhe hamësi dotë bënenë të-vobeq; edhe gjuni dot'a veshnjë njerinë me lecka.
- 22 Dëgjo t'ët atë që të ka pjellë; edhe mos e përqesh t'ët ëmë, kur të plaketë.
- 23 Bli të-vërtetënë, edhe mos e shit; po, diturinë, e mësimnë, e urtësinë.
- 24 I at'i të-drejtit dotë gëzonetë fort; edhe kush pjell *bir* të-urtë dotë gëzonetë për atë.
- 25 Yt atë a jot'ëmë letë gëzonenë; po, ajo që të polli letë ngazëllonetë.
- 26 § Biri im ep-më zëmërënë t'ënde, edhe syt'e tu letë shëfrenjënë nd'udhët të mia.
- 27 Sepse kurva është *posi* grop'e-thellë; edhe e-huaja *posi* pus i-ngushtë.
- 28 Po, ajo bën pritë posi kursar, edhe shton fajtorëtë ndër mest të njerësvet.
- 29 § Kush është i-mjerë? kush psherëtin? kush zihetë? kush flet fjalë të-kota? kush ka plagë pa ndonjë punë? kush ka sytë të-kuq?
- 30 Ata që ngrysenë ndë verët; ata që shkonjënë të kërkonjënë verë të-përzjerë.



- 31 Mos vështro verënë se është' e-kuqe, se ngjyen qeftinë, se sbret shijazi;
- 32 Mbë ndë funt kafshon posi gjarpër, e thumbon posi nepërkë.
- 33 Syt' e tu dotë shikonjënë gra të-huaja, edhe zëmëra jote dotë flasë *fjalë* të-paturpshime;
- 34 Po, dotë jesh posi ay që fle ndë kërthizët të detit, a posi ay që dergjetë ndë majët të drus' së lundrësë.
- 35 *Dotë thuash*, Më bininë, edhe nukë më dhëmppte; më rrihninë, edhe nukë ndjenja; kur dotë sgjonem, që të vete, e t'a kërkonj atë përsëri?

#### Krye 24.

- 1 Mos u ki zili njerëzvet të-liq, as mos dëshëro të jesh bashkë me ata.
- 2 Sepse zëmëra e atyre mendonetë shtrëngim, edhe buzët' e atyre flasënë të-këqia.
- 3 Me anë të urtësisë ndërtonetë shtëpia, edhe me anë të mëndjesë forconetë;
- 4 Edhe me anë të diturisë dotë mbushenë thesarëtë me çdo pasje të-paçëmuarë e të-gëzuarshime.
- 5 Njeriu i-urtë ka forcë, edhe njeriu i-mëncim shton fuqi.
- 6 Sepse me anë të-këshillave të-urta dotë bëjsh luftënë t'ënde, edhe nga shumica e këshilëset *vjen* shpëtimi.

7 Urtësia është fort e-lartë për të-marrinë;  
ay nukë dotë hapnjë gojën' e tij ndë portët.

8 Atë që mendonetë të bënjë keq njerëzitë  
dot'a quanjënë njeri keqbërës.

9 Mendimi i marrëzisë është faj; edhe për-  
qeshësi është ndyrësi ndër njerëzit.

10 Ndë humpç zëmërenë ndë ditë të-keqe, fu-  
qia jote qënka e-vogëlë.

11 Shpëto ata që shpihenë për të uvrarë, edhe  
mos umërigo nga ata që janë gati për të utherë.

12 Ndë thënc, Na neve tek nuk' e dimë këtë;  
a nuk' e di ay që peshon zëmëratë? edhe ay  
që ruan shpirtinë t'ënt, edhe i ep gjithë-sici-  
lit pas punëravet t' atij?

13 Biri im, ha mjaltë, sepse është' e-mirë; edhe  
hoj mjalte, q' është' e-ëmbëlë ndë qiellzët  
t' ënde;

14 Të këtillë dotë jetë të-njojturit' e urtësisë  
ndë shpirtt t'ënt; ndë e gjeç atë, atëhere dotë  
marrç çpagim *të-mirë*, edhe shpresa jote nukë  
dotë këputetë.

15 Mos ngrih kurth, o njeri i-lik, kundrë  
shtëpis' së të-drejtit; mos prish vëndin' e të-  
prëjturit t' atij;

16 Sepse i-drejti rrëzonetë shtatë herë, edhe  
prapë ngrihetë; po të-liqtë dotë prishenë prej  
mjerësie.

17 Mos ugëzo ndë të-rrëzuarët t' armikut t'ënt;  
edhe letë mos gëzonetë zëmëra jote ndë të-  
përmbysurit t' atij;

- 18 Semos shohë Zoti e i duket' e-keqe, e kthen zëmërimn' e tij prej atij.
- 19 Mos uzëmëro për keqbërësitë, as mos u ki zili të-liqvet;
- 20 Sepse nukë dotë ketë çpagim të-mirë për njerin' e-lik; kandilej' e të-liqvet dotë shuhetë.
- 21 Biri im, ki frikë Zotit edhe mbretit; edhe mos upërzjej me ata që sjellënë trazirë;
- 22 Sepse mjerësi' e atyreve dotë vinjë pa-pandehuraj; edhe kush e di prishjen' nga ata të dy?
- 23 § Edhe këto janë për të-urtëtë. Të-mbaj-turit' anë ndë gjyq nuk' është pun' e-mirë.
- 24 Atë që i thotë të-ligut, Ti je i-drejtë, *këtë* gjindjetë dot' e mallëkonjënë, edhe kombetë dot' e mërzitnjënë;
- 25 Po ndër ata që e qërtonjënë dotë jetë gëzim, edhe bekim i-mirë dotë vinjë mbi ata.
- 26 Kush ep përgjigje të-drejtë puth ndë buzët.
- 27 Ndrej punënë t' ende jashtë, edhe bën-e gati për vetëhenë t' ende nd' arët; edhe pas-taj ndërto shtëpinë t' ende.
- 28 Mos ubëj dëshmitar kundrë t' afërmit t' ënt pa ndonjë ngajë, as mos gënje me buzët' e tua.
- 29 Mos thuaj, Sikundrë m'a bëri mua, kështu dot' j'a bënj atij; dot' j'a çpaguej njeriut pas punës' s' atij.
- 30 Shkonjam ndëpër arët të-përtesësit, edhe ndëpër veshtët t' atij që s' ka mënt;

- 31 Edhe ja tek kishinë mbirë gjëmbe kudo;  
hithra i kishinë mbuluarë faqenë, edhe muri  
i-gurtë i asaj ishte rrëzuarë.
- 32 Atëherë dyke vënë re edhe dyke umendu-  
arë mirë, pashë, edhe nxura mësim.
- 33 Pak gjumë, pak të-dremiturë, pak të-pshte-  
llë duartë për të flejturë;
- 34 Edhe vobëzia jote vjen posi këmbësuar i-  
çpejtë, edhe skamja jote posi burr' i-arma-  
tosurë.

## Krye 25

- 1 Edhe këto janë fjalë të-urta të Sollomonit,  
të-cilat' i mlothnë njerëzit' e Ezeqiu, mbretit  
të Judhesë.
- 2 Lavdia e Perëndisë është të mbulonjë pu-  
nënë; po lavdia e mbretërvet është të gje-  
njënë çështjenë.
- 3 Të-lartët' e qiellit, e të-thellët' e dheut, e  
zëmëra e mbretërvet, janë të-pavëzhguarshime.
- 4 Hiq ndryshkunë nga ergjëndi, edhe dotë  
dalë enë për ergjëndarinë;
- 5 Hiq të-liqtë që përpara mbretit, edhe fronti  
i atij dotë forconetë ndë drejtëri.
- 6 Mos umburr përpara mbretit, edhe mos rri  
ndë vëntt të të-mëdhenjet;
- 7 Sepse më mirë është të të thonë, Hip këtu,  
se të sbritesh më poshtë përpara të të-parit  
që panë syt' e tu.
- 8 Mos unxito të dalç për të zënë, semos nukë-

dish mbë ndë funt, ç' të bënç, kur të të tur-  
përonjë i afërmi yt.

9 Gjyko-e gjyqinë t' ënt vetë me të-afërminë  
t' ënt; edhe mos sbulo të-fshehëtën' e tjatërit;

10 Semos të shanjë ay që dëgjon, edhe tur-  
përia jote nukë hiqetë më.

11 Fjala që flitetë tek ka vëndinë është *posi*  
mollë të-arta ndër enë të-ergjëntta.

12 Posi vëth i-artë edhe posi stoli prej ari  
të-qëruare është i-urti që qërton veshi të-dë-  
gjuarshim.

13 Posi të-ftohëtiti' e dëborësë ndë kohët të  
të-korrit, *kështu është* lajmësi besëtar tek ata  
që e dërgonjënë, sepse prën shpirtin' e zotëret  
të tij.

14 Kush mburretë për dhurëti të-gënjeshtretë  
është posi re e erë pa shi.

15 Zotërisë i mbushetë mëndja me durim;  
edhe gjuh' e hëmbëlë thyen eshtëra.

16 Gjete mjaltë? mos ha tepërë, semos fryhesh  
tepërë nga ajo, e e vjell.

17 Rallë vërë këmbënë t'ënde ndë shtëpit të  
t' afërmit t' ënt; semos rëndonetë prej teje,  
e të mërzit.

18 Ay njeri që dëshmon dëshmim të-rrem  
kundrë t' afërmit të tij është *posi* kopaçe, e  
*posi* thikë, e *posi* shëgjet' e-mbrehëtë.

19 Të-pasurë besë mbë njeri të-pabesë ndë  
ditë të-zezë është *posi* dhëmp i-prishurë e  
*posi* këmb' e-dalë vëndit.

- 20 *Posi* ay që svesh rrobënë ndë kohë të-ftohëtë, *e posi* uthulla moi nitrët, kështu është ay që i këndon kënkë zëmërës' së-helmuarë.
- 21 Ndë ka uri armiku yt, ep-i bukë të hajë; edhe ndë ka et, ep-i ujë të pijë;
- 22 Sepse dotë grumbullonç thëngjij zjarri mbi kryet t' atij, edhe Zoti dotë t'a çpaganjë.
- 23 Er' e borësë bie shinë; kështu faqen' e vrerëtë gjuha që pishtëllin.
- 24 Më mirë të rrijë *njeriu* ndë një çip të mbulesës' së *shtëpisë* se ndë shtëpi të-gjerë me grua që i ka ënda të zihetë.
- 25 *Posi* ujërat' e-ftohëta ndë shpirt të-etshim, kështu është zër' i-mirë nga dheu i-largë.
- 26 Njeriu i-drejtë, i-cili bie *ndë faj* përpara të-ligut, është *posi* krua i-trumbullë e *posi* burim i-prishurë.
- 27 Sikundrë nuk' është mirë të hajë *njeriu* shumë mjaltë, kështu nuk' është mirë të kërkonjë lavdin' e vetëhes' së tij.
- 27 Kush nuk' është zot i shpirtit të tij është *posi* qytet i-rrëzuarë e pa mur.

## Krye 26.

- 1 *Posi* dëbora ndë verët, edhe *posi* shiu ndë të-korrët, kështu nuk' i ka hie nderi të-marrit.
- 2 Sikundrë zogu sillet' andej e këtej, sikundrë fluturon delëndyshja, kështu s' ka për të ardhurë mallëkimi që bënetë pa *ndonjë* ngajë.

- 3 Shufra është për kalinë, freri për goma-  
rinë, edhe shkopi për kurrizin' e të-marrëvet.
- 4 Mos i upërgjeq të-marrit pas marrëzis' s'  
atij, që të mos bënesh edhe ti shoqi i atij.
- 5 Përgjigju të-marrit pas marrëzis' s' atij, që  
të mos jet' i-urtë ndër syt të tij.
- 6 Kush dërgon zë me dorën' e të-marrit pret  
këmbët' e tia edhe pi dëm.
- 7 *Posi* kërcinjt' e të-çalit varenë pa dobi,  
kështu është edhe fjal' e-urtë ndë gojët të të-  
marrëvet.
- 8 Posi një trajstë gurësh të-paçëmuarë ndë  
një tog gurësh, kështu është ay që i bëu nder  
të-marrit.
- 9 *Posi* gjëmbi që nguletë ndë dorët të të-  
dejturit, kështu është edhe fjal' e-urtë ndë  
gojët të të-marrëvet.
- 10 *Posi* një harkëtar që plagos të-gjitha, kë-  
shtu është ay që merr ndë shërbim të-ma-  
rrinë edhe ay që pajton ata që shkonjënë  
*udhësë*.
- 11 Posi qëni kthenetë ndë të-vjellët të tij,  
kështu edhe i-marri përsërit marrëzit' e tia.
- 12 A sheh njeri që pandeh vetëhen' e ti të-  
urtë? më tepërë shpresë është nga i-marri-  
se nga ay.
- 13 Kush përton thotë, Leon ka mb' udhët;  
leon ka ndëpër rrugat.
- 14 *Posi* dera kthenetë mbi boshtet të saj,  
kështu *kthenetë* edhe përtaci mbi shtratt të

- 15 Përtaci ngjyen dorën' e tij ndë kupët, *edhe* rëndonetë t'a kthenj' atë ndë gojët të tij.
- 16 Përtaci pandeh vetëhen' e tij më të-urtë se shtatë veta që muntnjënë të apënë mëndje të-urtë.
- 17 Kush shkon udhësë *edhe* zëmëronetë për qartë që s'ka të bënjë me atë i gjan ati që zë qënë prej veshësh.
- 18 *Posi* i-çmënduri që heth urë të-ndezura, shëgjeta e mortje,
- 19 Kështu është ay njeri që gënjen të-afërmin' e tij, e thotë, A nuk' e bëra unë këtë dyke lozurë?
- 20 Tek s'ka dru zjarri shuhetë; edhe tek s'ka pishtëllonjës qarta pushon.
- 21 Thëngjijtë janë për të nxehurë shpuzënë, edhe drutë për zjarrinë, edhe njeriu që do grindje është për të ndezurë qarta.
- 22 Fjalët' e pishtëllonjësit janë si kafshita të-shishme, edhe sbresënë ndë të-përbrëndëshmet anë të barkut.
- 23 Buzët' e-ndezura edhe zëmëra e-keqe janë posi ndryshk ergjëndi lyerë mbi enë të-balttë.
- 24 Kush ka cmir e fsheh me buzët' e tia, po mendonefë kobim ndë zëmërët të tij;
- 25 Kush flet fjalë të-ëmbëla, mos e beso; sepse ka shtatë *palë* ndyrësira ndë zëmërët të tij;
- 26 Ndonëse mbulon emërin' e ti me kobim,



ligësia e atij dotë tregonetë faqeza përpara përmbledhjesë.

27 Kush rëmon gropë dotë bjerë nd' atë; edhe guri dotë kthenetë mbi atë që e rrukullis.

28 Gjuha e-rreme ka cmir ata që shtrëngonënë prej asaj; edhe goja që përkëdhel punon prishje.

### Krye 27.

1 Mos umburr për ditën' e-nesërme; sepse nukë di seç dotë pjellë dita.

2 Letë të lëvdonjë tjatëri, e mos goja jote; i-huaji, e mos buzët' e tua.

3 Guri është' i-rëndë, edhe rëra s' mbaretë dot; po zëmërimi i të-marrit ështëë më i-rëndë se këto të dyja.

4 Mëria është' e-ashpërë, edhe zëmërata si vërshim ujërash; po kush munt të qëndronjë përpara zilisë?

5 Qërtimi i-çfaqurë ështëë më i-mirë se dashuria e-fshehurë.

6 Plagët' e mikut janë të besësë; po të-puthurat' e armikut të-panumëruara.

7 Shpirti i-nginjurë e mërzit mjaltën' e hojvet; po shpirtit të-urishim çdo gjë e-hidhurë *i vjen* e-ëmbëlë.

8 *Posi* zogu i-arratisurë nga folej' e tij, kështu ështëë njeriu i-arratisurë nga vëndi i tij.

9 Vajëratë me erë edhe thimiamatë e gëzo-

njënë zëmërënë; *kështu* edhe ëmblësir' e mikut me këshillë prej zëmëre.

- 10 Mos hiq dorë nga miku yt, e nga miku i t'yt et; edhe mos hyrë ndë shtëpit të t'yt vëllaj ndë ditët të fatkeqërisë s'ate; *sepse* më i-mirë është fqiri i-afërm se vëllaj i-largë.
- 11 Biri im, bënu i-urtë, edhe gëzo zëmërënë t'ime, që të kem seç t'i përgjigjem atij që më shan.
- 12 Njeriu i-urtë sheh të-ligënë, *edhe* fshihetë; po të-mituritë venë përparë *edhe* mundonënë.
- 13 Merr rrobën' e dorëzënësit për të-huajnë, edhe merr peng *prej atij që zotonetë* për të-huajnë.
- 14 Kush ngrihetë ndë mëngjest edhe bekon me zë të-math të-afërmin' e tij, dotë numëronetë sikur e mallëkon.
- 15 Pika që s' pushon ndë ditët të shiut edhe gruaja që i ka ënda të zihetë janë si-një-një;
- 16 Ay që fsheh atë fsheh erënë, edhe vaji me erë ndë të-djathtët t'atij çfaq vetëhenë.
- 17 Hekuri preh hekurinë; edhe njeriu preh faqen' e mikut të tij.
- 18 Kush ruan drurin' e fikut dotë hajë pemën' e atij; edhe kush ruan të zonë dotë nderonetë.
- 19 Sikundrë ndë ujët faqeja përgjigjetë ndë faqet, *kështu* edhe zëmëra e njeriut te njeriu.
- 20 Hadhi edhe prishja s'nginjenë; edhe syt' e njeriut s'kanë të-nginjurë.

- 21 Ergjëndi provonetë me enën' e të-çkririt, edhe ari me kaminënë; po njeriu me atë *gjë* që lëvdon.
- 22 Edhe ndë shtypsh të-marrinë me shtypësinë ndë shtypect ndë mest të grurit që shtypetë, marrëzia e ati nukë dotë ndahetë prej atij.
- 23 Kujdesu të dish gjendjen' e kopevet të tua, edhe shiko mirë lopët' e tua;
- 24 Sepse pasja nuk' është e-përjetëshme, edhe kurora nukë qëndron bres pas brezi.
- 25 Bari mbaretë, edhe bari i-njomë duketë, edhe barërat' e malevet mblidhenë.
- 26 Shqeratë janë për rrobat' e tua, edhe cjeptë janë çëmim' i arësë;
- 27 Edhe dotë kesh mjaft qumësht dhish për ushqimnë t'ënt, për ushqimn' e shtëpisë s'ate, edhe për jetën' e shërbëtorevet të tua.

### Krye 28.

- 1 Të-liqtë ikënjënë *edhe* kur asnjeri s'i ndjek; po të-drejtëtë janë të-kuxuarshin' posi leon.
- 2 Për fajet' e vëndit shumë janë krerët' e ati; po me anë njerësve të-mënçim e të-urtë pusheti *i atij* dotë sgjatetë.
- 3 Njeriu i-vobek që shtrëngon të-vobeqtë është *posi* shiu i-fortë që nukë lë pas bukë.
- 4 Ata që lënë nomnë lëvdonjënë të-liqtë; po ata që ruanjënë nomnë rrinë kundrë atyreve.
- 5 Njerëzit' e-liq nukë kupëtonjënë gjyq; po

- ata që kërkonjënë Zotinë dotë kupëtonjënë të-gjitha.
- 6 Më i-mirë është i-vobegu, që ecën ndë tërësit të tij, se ay që është i-shtrëmbërë mbë udhët të tia, edhe ndë qoft' i-pasurë.
- 7 Kush ruan nomnë është djal' i-urtë; po ay që bënetë shok i plankprishësvet turpëron t' anë.
- 8 Kush shton gjën' e tij me uzurë e me lakmim, e mbleth atë për atë që përdëllen të-vobeqtë.
- 9 T' atij që kthen mbë nj' anë veshin' e ti që të mos dëgjonjë nomnë, edhe të-faluritë është ndyrësi.
- 10 Kush shpie të-drejtëtë mb' udhë të-ligë, ay vetë dotë bjerë ndë gropët të tij; po të-sosuritë dotë trashëgonjënë të-mira.
- 11 Njeriu i-pasurë pandeh vetëhen' e tij të-diturë; po i-vobegu me mënt e qërton atë.
- 12 Kur fitonjënë të-drëjtëtë, është lavdi e-madhe; po kur lartonenë të-paudhëtë, njerëzitë fshihenë.
- 13 Kush fsheh fajet' e tij nukë dotë vejë mbarë; po kush i rrëfen edhe heq dorë nga ata dotë gjenjë përdëllim.
- 14 Lum ay njeri që ka frikë përherë; po kush ashpëron zëmërën' e tij dotë bjerë ndë mjerësi.
- 15 *Posi* leon që ulërin edhe *posi* ari që ka uri është i-paudhi që urdhëron mbi gjindje të-vobegë.

- 16 Ay zotëni që s'ka mënt është edhe mundonjës i-keq; po ay që mërzit lakmimnë dotë sgjatnjë ditt' e tia.
- 17 Njeriu që është fajtuar për gjak njeriu, dotë çpejtonjë ndë gropët; asnjeri letë mos e mbanj' atë.
- 18 Kush ecën ndë të-drejtët dotë shpëtonjë; po i-shtrëmbëri nd' udhët *të tia* dotë bjerë përnjëhere.
- 19 Kush punon dhen' e tij dotë ketë plotësi buke; po kush vete pas njerësve të-kotë dotë ketë mjaft vobëzi.
- 20 Njeriu besëtar dotë ketë shumë bekime; po ay që nxitonetë të bënet' i-pasurë nukë dotë mbetet' i-pamunduarë.
- 21 Njeriu t' i mbanjë anë tjatërit nuk' është mirë; sepse *i këtulli* njeri për një copë bukë dotë punonjë paudhëri.
- 22 Kush ka sy të-lik nxitonetë të bënet' i-pasurë, edhe nuk' e di se nevoja dotë vinjë mbi atë.
- 23 Kush qërton njerinë pastaj dotë gjenjë më tepërë hir se ay që përkëdhel me gjuhë.
- 24 Ay qe vjeth t' an' a t' ëmënë, edhe thotë, *Këjo* nuk' është faj, ay është shoku i kursarit.
- 25 Kush është madhështuar ndë zëmëret ndes qarta; po kush besonetë mbë Zotinë dotë mahetë.
- 26 Kush besonetë mbë zëmëren' e tij është i-marrë; po kush ecën me urtësi dotë shpëtonjë.

- 27 Kush u ep të-vobeqvet nukë dotë arinjë  
ndë nevojë; po kush kthen mbe nj' anë syt'  
e tij dotë këtë shumë mallëkime.
- 28 Kur lartonenë të-liqtë, njerëzite fshihenë;  
po ndë humbjet t' atyre të-drejtëtë shtonenë.

## Krye 29.

- 1 Ay njeri, që qërtonetë shumë herë, edhe  
ashpëron qafën' e tij, papandehuraj dotë thy-  
hetë, edhe këtë pa *shpresë* shërimi.
- 2 Kur shtonenë të-drejtëtë, gjindja gëzonetë;  
po kur ka pushtet njeriu i-lik, gjindja pshe-  
rëtin.
- 3 Kush do urtësinë gëzon t' anë; po kush  
bën shoqëri me kurvatë prish gjën' e tij.
- 4 Mbreti me anë të drejtërisë forcon vëndinë;  
po kush merr mitë e prish atë.
- 5 Ay njeri që përkëdhel t' afërmin' e tij, nden  
rrietë për çapet' e atij.
- 6 Ndë paudhërit të njeriut të-lik ka dhokan;  
po i drejti këndon e gëzonetë.
- 7 I-drejti e njuh gjyqin' e të-vobegut; *po* i-  
ligu nukë kujdesetë t' a dijë.
- 8 Njerëzitetë përqeshës i vënë flakë qytetit; po  
të-urtëtë e largonjënë zëmërimnë.
- 9 Njeriu i-urtë, kur hahetë me njerin' e-marrë,  
ndo zemëronetë, ndo qesh, nukë gjen të-  
prëjturë.
- 10 Njerëzitetë gjakëtorë e mërzi:tnjëne atë që

është i-sosurë; po të-drejtëtë kujdesenë për jetën' e atij.

11 I-marri e rrëfen zëmërimn' e tij; po i-urti e përmban atë.

12 Urdhërtari ndë u vë veshnë fjalëvet të-rrreme, gjithë shërbëtorët' e atij janë të-liq.

13 I-vobegu edhe mundonjësi pjekënë njëri tjetërinë; Zoti u ndrit sytë të dyve.

14 Mbreti kur gjykon me drejtëri të-vobeqtë, fron' i atij dotë forconetë për jetë.

15 Shkopi edhe qërtimi apënë urtësi; edhe djal' i-lënurë ndë vetëhet të tij turpëron t'ëmënë.

16 Kur shumohenë të-liqtë, shtonetë paudhëria; po të-drejtëtë kanë për të parë të-rrëzuarët' e atyre.

17 Mundo t' ët bir, edhe dotë t' apë të-prëjturë; po, dot' i apë gëzim shpirtit t' ënt.

18 Atje tek s'ka të-faniturë, gjindja prishetë; po ay që ruan nomnë është' i-lumurë.

19 Shërbëtori nukë ndreqetë me fjalë, sepse, ndonëse kupëton, nukë përgjigjetë.

20 A sheh njeri të-çpejtë ndë fjalët? më tepërë ka shpresë nga i-marri se nga ay.

21 Ndë rritë ndonjë shërbëtorin' e tij që ndë vogëlit me të-butë, më ndë funtt *ky* dot' i bënëtetë bir.

22 Njeriu zëmërak ndes qarta; edhe njeriu i-zëmëruarë shton të-ligatë.

- 23 Madhështia e njeriut dot' e përunjë atë;  
po zëmërë-unjuri dotë nderonetë.
- 24 Kush merr pjesë me kursarinë ka cmir-  
shpirtin' e tij; dëgjon benë, edhe nukë rrëfen.
- 25 Frika e njeriut ngreh kurth; po kush shpren  
mbë Zotinë dotë jetë ndë siguri.
- 26 Shumë veta kërkonjënë syn' e-mirë të ur-  
dhërtarit; po gjyqi i njeriut është prej Zotit.
- 27 Njeriu i-paudhë është i-mërziturë ndër të-  
drejtët; edhe ay që është i-drejtë mb' udhët  
të tija është ndyrësi ndër të-paudhët.

## Krye 30.

- 1 Fjalët' e Agurit, birit të Jakehut, do-me-  
thënë profitia që i foli njeriu Ithiilit, Ithiilit  
edhe Ukalit.
- 2 Me të-vërtetë unë jam më i-marri i nje-  
rëzet, edhe kupëtim njeriu nukë *gjëndetë* tek  
unë;
- 3 Edhe urtësi nukë nxura, as nukë kam  
diturin' e Shënjtit.
- 4 Cili hipi ndë qiellt edhe sbriti? Cili mblodhi  
erënë ndë grushtet të tij? Cili lidhi ujëratë-  
ndë rrobët të tij? Cili forcoj gjithë anët' e-  
dheut? Ç' është emër' i atij edhe ç' është emëri  
i të birt, ndë e di?
- 5 Çdo fjalë e Perëndisë është e-provuarë;  
është mburonjë mb' ata që besonenë mb' atë.
- 6 Mos shto *gjë* ndër fjalët t' atij, që të mos  
të qërtonjë, edhe del gënjeshtar.



- 7 § Dy gjërëra kërkonj prej teje; mos m' i mohonjç *këto* përpara se të vdes:
- 8 Të mërgonjç prej meje kotësirën' e gënjeshtatë; të mos më apç as vobëzi as pasje; ushqe-më me ushqimnë që është' i-nevojshim për mua;
- 9 Semos nginjem, e të mohonj, e them, Ç' është Zoti? a semos ndodhem i-vobek, e vjeth, e përdor me çnderim emërinë t' ënt.
- 10 § Mos përfole shërbëtorinë tek i zoti; semos të mallëkonjë, e të zë faji.
- 11 § Ka bres që mallëkon t' anë, edhe nukë bekon t' ëmënë.
- 12 Ka bres të-kthjellëtë ndë syt të tij, po edhe nuk' është i-larë nga ndyrësira e tij.
- 13 Ka bres, të-cilit sa të-lartë janë sytë, edhe sa të-ngritura janë qepallat' e atij!
- 14 Ka bres, të-cilit dhëmbëtë janë kordha, edhe dhëmballatë thika, që të brenjënë të-vobeqtë prej dheut, edhe skamësitë prej mezit të njerëzet.
- 15 Piavica ka dy bija, që thërresënë, Bjerë, bjerë. *Këto* të tria s'kanë të-nginjurë kurrë, po, këto të katra nukë thonë *kurrë*, Mjaft;
- 16 Varri, edhe shtrati i shterpësë; dheu që nukë ngjinjetë me ujë, edhe zjarri që nukë thotë, Mjaft.
- 17 Synë që përqesh t' anë, edhe nukë do t'i dëgjonjë s' ëmësë, korbat' e shkëmbit dot' a nxjerrënë, edhe zoqt' e shqiponjavet dot'a hanë.

- 18 Këto të tria janë fort të-çudiçime tek unë,  
po, katrë gjërëra nukë kupëtonj;
- 19 Gjurmët' e shqiponjësë ndë erët; gjurmët'  
e gjarpërit përmbi shkëmpt; gjurmët' e lun-  
drësë ndë mest të detit; edhe gjurmët' e nje-  
riut me një vajzë.
- 20 E-këitillë është udha e gruasë kurvë; ha  
e fshin gojën' e saj, edhe thotë, Nukë bëra  
ndonjë paudhëri.
- 21 Për tri punë dridhetë dheu, po, për katrë,  
*të-cilatë* nukë munt t' i duronjë;
- 22 Për shërbëtorinë, kur mbretëron; për të-  
marrinë, kur nginjetë me bukë;
- 23 Për gruan' e-mërziturë, kur martonetë; edhe  
për shërbëtorenë, kur dëbon të zonjënë.
- 24 Ka katrë gjërëra që janë fort të-vogëla  
mbi dhet, po të-cilatë janë fort të-mënçime;
- 25 Melingonjatë nukë janë gjindje e-fortë, po  
ndë verët bënjënë gati ushqimn' e tyre;
- 26 Lepurat' e ujdhesavet janë gjindje e-pafu-  
qishime, po bëjnë shtëpit' e tyre ndë skkëmpt;
- 27 Karkalecatë s' kanë mbret, po të-gjithë da-  
lënë bashkë tufë tufë;
- 28 Merimaga mbahetë me këmbët' e saj, po  
rri ndëpër pallatet të mbretërvet.
- 29 Këto të tria ecënjënë mirë, po, katrë ecë-  
njënë hieshim;
- 30 Leoni, *që-është* m' i-forti ndër mest të  
shtëzavet, edhe prej asgjëje nukë kthenetë  
prapa;

- 31 Langoj, edhe cjapi; edhe mbreti që është qarkuarë nga gjindja e tij.
- 32 Ndë paç punuarë pa mënt dyke lartuarë vetëhenë, a ndë paç menduarë keq, *vërë* dorënë t' ende mbi gojët t' ende.
- 33 Sepse kush rreh qumësht, nxjer gjalpë; edhe kush strëngon hundënë, nxjer gjak; edhe kush ndes zëmërim, nxjer qarta.

## Krye 31.

- 1 Fjalët' e mbretit Lemuil, profitia që i mësoj e ëma.
- 2 Çë, biri im? edhe çë, o djalë i barkut t' im? Edhe çë, o bir' i të-faluravet të mia?
- 3 Mos u' a apç fuqinë t' ende gravet, as udhët' e tua atyreve që prishnjënë mbretëritë.
- 4 Nuk' është për mbretëritë, o Lemuil, nuk' është për mbretëritë të pinë verë; as për urdhërtarëtë *të pinë* të-pira të-forta;
- 5 Se dyke pirë mos harronjënë nomnë, edhe strëmbëronjënë gjyqin' e atyreve që janë ndë shtrëngim.
- 6 Ep-i-ni të-pira të-forta atij që po humbetë, edhe verë atij që ka hidhërim ndë shpirt;
- 7 Letë pië e të harronjë vobëzin' e tij, edhe të mos kujtonjë më fatkeqërin' e tij.
- 8 Hap gojënë t' ende për të-pagojinë, për gjyqin' e gjith' atyreve që janë të-shkretuarë.
- 9 Hap gojënë t' ende, edhe gjyko drejtë, edhe mburo të-vobegunë edhe të-nevojshiminë.

- 10 § Kush munt të gjenjë grua të-mirë? sepse e-këtilla është shumë m' e-vëjyerë se gurët' e-paçëmuarë.
- 11 Zëmëra e burrit t' asaj besonetë mb' atë, edhe nukë dot' i shteretë plotësi.
- 12 Dot' i bjerë ati të-mira, e jo të-këqia, gjithë ditt' e jetës' së saj.
- 13 Kërkon lesh e li, edhe i k'ënda të punonjë me duart' e saja.
- 14 Është posi lundrat' e tregëtarëvet; bje u-shqimin' e saj prej së-largu.
- 15 Edhe ngrihetë tek është *edhe* natë, edhe u ep të-ngrënë *njerësvet* të shtëpis' së saj, edhe punën' e tyre shërbëtorevet të saj.
- 16 Vështron arë, edhe e blen; edhe me punën' e duarvet të saj vë veshtë.
- 17 Ngjesh brezin' e saj me fuqi, edhe forcon krahët' e saj.
- 18 Ndjen se trëgëtia e saj është e-mirë; kandidatej' e asaj nukë shuhetë natënë.
- 19 Vë duart' e saj ndë boshtt, edhe duart' e asaj mbanjënë furkënë.
- 20 Hap dorën' e saj ndër të-vobeqt, edhe nden duart' e saj ndër ata që kanë nevojë.
- 21 Nuk' i ka frikë dëborësë për njerëzit' e shtëpis' së saj; sepse gjithë *njerëzit'* e shtëpis' së saj janë veshurë me *të-veshura* të-kuqe.
- 22 Bën mbulesa për vetëhen' e saj; rrob' e asaj është *prej* liri të-hollë e *prej* porfyre.

- 23 Burri i asaj njihetë ndër portat, kur rri  
ndë mest të pleqvet të vëndit.
- 24 Bën rroba të-linjta edhe i shet; edhe u  
ep breza tregëtarëvet.
- 25 Është veshurë me fuqi e me bukuri, edhe  
gëzonetë për kohëaë që vjen.
- 26 Hap gojën' e saj me urtësi, edhe mbi gjuhët  
t' asaj është nom dashurie.
- 27 Vë re mirë udhët' e *njerësvet* të shtëpis'  
së saj, edhe bukë përtimi nukë ha.
- 28 Djemt' e asaj ngrihen' edhe e lumëronjënë;  
po edhe burri i asaj e lavduron, dyke thënë:
- 29 Shumë bija kanë qënë të-vëjyera, po ti i  
kapërxeve të-gjitha.
- 30 Ëmblësir' e *faqesë* është' e-rreme, edhe  
bukuria e-kotë; *po* gruaja që i ka frikë Zotit,  
ajo dotë lëvdonetë.
- 31 Epni asaj prej pemës' së duaret t' asaj,  
edhe punët' e asaj let' a lëvdonjën' atë ndër  
portat.





